www.magazineforyou.com • www.facebook.com/Magazine4Ushqip

for 4U You

Revistë mujore e KFOR-it • Nr.147 • Maj 2018

EDITORIAL

"Dashuria e nënës për fëmijën e saj nuk krahasohet me asgjë tjetër në botë. Nuk njeh ligj e as mëshirë. Ajo përballon çdo gjë dhe mënjanon absolutisht gjithçka që i del përpara asaj."
Agatha Christie

Asgjë në këtë botë nuk mund të krahasohet me dashurinë dhe kujdesin e vërtetë të nënës sonë. Ajo është gruaja e vetme, në kuptimin e plotë të fjalës, në jetën tonë që na do dhe interesohet aq shumë për ne pa asnjë qëllim personal të saj. Fëmiu është çdo gjë për një nënë. Ajo gjithnjë na nxit të bëjmë gjëra të vështira në jetë sa herë që jemi të pafuqishëm. Ajo është një dëgjuese e mirë dhe dëgjon çdo gjë të keqe ose të mirë që ne e themi. Ajo kurrë nuk na kufizon dhe pamundëson ndonjë gjë, të cilës i është vënë kufiri. Ajo na aftëson të bëjmë dallim midis të mirës ose të keqes.

Dashuria e vërtetë është një emër tjetër që vetëm një nënë mund ta ketë. Që nga koha kur jemi ngjizur në mitrën e saj, kemi lindur dhe gjatë gjithë jetës së saj në këtë botë, ajo na jep kujdes dhe dashuri të pakusht. Ajo është e vetmja që fillon shkollimin tonë për herë të parë në shtëpi dhe bëhet mësuesja e parë dhe e dashur e jetës sonë. Ajo na mëson mësimet e sjelljes dhe filozofitë e vërteta të jetës. Nuk ka dashuri më të qëndrueshme, më të fortë, më altruiste, më të pastër dhe më të përkushtuar në këtë botë. Ajo është personi që sjell dritë në jetën tonë duke na hequr të gjithë errësirën.

Ajo shqetësohet shumë çdoherë për shëndetin, arsimin, të ardhmen dhe sigurinë tonë nga të huajt e tjerë. Ajo gjithmonë na drejton në rrugën e duhur të jetës dhe më e rëndësishmja, ajo shpërndan lumturinë e vërtetë në jetën tonë. Nga një fëmijë i vogël dhe i paaftë, ajo na bën njeri të fortë në aspektin mendor, fizik, shoqëror dhe intelektual. Ajo na e mbanë gjithmonë anën dhe i lutet Zotit për mirëqenien tonë dhe të ardhmen e ndritshme gjatë gjithë jetës, edhe kur e trishtojmë ndonjëherë. Por, prapa fytyrës së saj gjithmonë të lumtur fshihet trishtim i madh, të cilën ne duhet të kemi mundësinë ta lexojmë dhe të kujdesemi për të.

Në fund, do të doja t'ua uroja nga zemra Ditën e Nënës gjithë nënave të mrekullueshme në botë dhe i kërkoj Zotit t'i mëshirojë dhe mbrojë ato në mënyrë që të vazhdojnë gjithmonë me rolin e tyre sfidues.

Leonora

INDEKSI

Kopertina:
Florent ABRASHI

HI-TECH

MBRETËRIA E KAFSHËVE



MOVIEMANIA

2-3: Editoriali, indeksi
4-5: Shkolla e muajit: SHFMU "Bajram Curri" në Sllatinë të Madhe;
Pyetësor: Nëse do të haje vetëm një ushqim gjatë tërë jetës, cili do të ishte ai ushqim dhe pse?
6-7: "SILVER SABRE – 2018-1"
8-9: Fashion: Barbi kukullat më të shtrenjta në botë
10-11: Music Box: Florent Abrashi
12-13: Kujdes minat!
14-15: Mbretëria e kafshëve: Kafshët më të lezetshme në botë
16-17: Poster: Florent Abrashi
18-19: Moviemania: The untitled deadpool sequel; The son of bigfoot; Lu over the wall; Tully
20-21:Këndi sportiv: Punoni fort për t'i realizuar ëndrrat e juaja!
22-23: Hi-Tech
24-25: #WikiGap - Të mbulojmë hendekun gjinor në internet
26-27: Punësim i mirë dhe rritje ekonomike
28-29: Këndi juaj ...
30: Këndi enigmatik
31-32: Letrat e lexuesve

"For You" është publikim zyrtar i KFOR-it, prodhuar dhe financuar nga KFOR-i, i shtypur në Kosovë dhe shpërndahet pa pagesë. Përmbajtja nuk reflekton qëndrimin zyrtar të koalicionit apo të shteteve anëtare. KFOR-i pranon edhe i mirëpret opinionet tuaja dhe i publikon ato, por në formë të përmbledhur. Nëse kërkohet emri i shkrimtarit të mos tregohet, kjo mund të bëhet, por nuk do të publikohen letra anonime, shpifëse apo me qëllim të keq.

Kryeredaktore: Leonora Shabanaj Nikshiq
Gazetarë: Ali Rexha, Violeta Matovic
Fotografitë: Ekipi "4U"
Design & Layout: Bekim Shabani

Stafi editorial mund të kontaktohet në telefon: 038/503-603-2139
Letrat mund të dërgohen në adresën:
HQ KFOR - Kosova Film.
Revista "For You"; Strasbourg Building; 10000 Prishtinë
E-mail: ***magazineforyou2003@gmail.com;***
http://www.magazineforyou.com

INDEX

POSTERI

"SILVER SABRE - 2018-1"

SHKOLLA E MUAJIT

KUJDES MINAT!

EDITORIAL

"A mother's love for her child is like nothing else in the world. It knows no law, no pity. It dares all things and crushes down remorselessly all that stands in its path."
Agatha Christie

Nothing in this world can compare with the true love and care of our mother. She is the one and only woman of our life who loves and cares us so much without any personal intention of her. A child is everything for a mother. She always encourages us to do any hard things in the life whenever we become helpless. She is the good listener of us and listen everything bad or good what we say. She never restricts and limits us to any limitation. She makes us able to differentiate between good or bad.

True love is another name of a mother which only a mother can have. From the time we come in her womb, takes birth and throughout her life in this world, she give us tired less care and love. She is the one who starts our schooling first time at home and becomes a first and lovely teacher of our life. She teaches us behaviour lessons and true philosophies of the life. There is no love in this world which is so lasting, strong, unselfish, pure and devoted. She is the one who brings lights in our life by removing all the darkness.

She always becomes very anxious about our health, education, future and our safety from other strangers. She always leads us towards right direction in the life and most importantly she scatters true happiness in our life. She makes us strong human being mentally, physically, socially and intellectually from a small and incapable child. She always takes side of us and prays to God for our wellness and bright future all through the life even after we make her sad sometimes. But there is lots of sadness behind her always happy face which we need to understand and take care of her.

In the end, I would like to wish a very Happy Mother's Day to all the wonderful mothers in the world and I truly seek God's grace and protection for them so that they keep up with their challenging role always.

Leonora

2-3: Editorial, index
4-5: School of the month: EJHS "Bajram Curri" in Sllatinë e Madhe
Questionnaire: If you were to eat only one food during your entire life, what would it be and why?
6-7: "SILVER SABRE – 2018-1"
8-9: Fashion: Most expensive barbie dolls in the World
10-11: Music Box: Florent Abrashi
12-13: Beware of mines!
14-15: Animal Kingdom: Cutest animals in the world
16-17: Poster: Florent Abrashi
18-19: Moviemania: The untitled deadpool sequel; The son of bigfoot; Lu over the wall; Tully
20-21: Sports corner: Work hard to make your dreams come true!
22-23: Hi-Tech
24-25: #WikiGap - Let's close the Internet gender gap
26-27: Decent work and economic growth
28-29: Your corner ...
30: Puzzle
31-32: Reader's letters

'For You' is an official publication of KFOR, produced and financed by KFOR, printed in Kosovo and distributed freely.The contents do not necessarily reflect the official point of view of the coalition or that of any of its member states. KFOR accepts and welcomes your opinions, it will publish some of these, eventually in a condensed form. If requested the name of the writer will be withheld but no anonymous, defamatory or malicious letters will be printed.

Chief Editor: Leonora Shabanaj Niksic
Journalists: Ali Rexha, Violeta Matovic
Photos by: "4U" team
Design & Layout: Bekim Shabani

The editorial staff can be contacted on: 038/503-603-2139
Any letters can be sent at: HQ KFOR - Film City;
For You magazine; Strasbourg building; 10000 Pristina;
E-mail: ***magazineforyou2003@gmail.com;***
http://www.magazineforyou.com

SHFMU "BAJRAM CURRI" NË SLLATINË TË MADHE

z. Tahir Shabani

Shkolla Fillore dhe e Mesme e Ulët (SHFMU) "Bajram Curri" në Sllatinë të Madhe me plotë të drejtë konsiderohet si djepi i arsimit për rajonin e Drenicës, Rrafshit të Kosovës dhe Gollakut. Kjo për arsye se ajo për herë të parë u hap në vitin 1924 kurse, mësimi asokohe zhvillohej në gjuhën serbo-kroate. Më pas në vitin shkollor 1941-1942 mësimi filloi të mbahej në gjuhën shqipe. Pas Luftës së Dytë Botërore, shumë nxënës që e kishin mbaruar arsimin fillor në këtë shkollë u angazhuan për të dhënë mësim në të tria rajonet e sipërpërmendura.

Krahas rëndësisë për hapjen e shkollave të reja në trevat e ndryshme të Kosovës, shkolla në Sllatinë të Madhe njihet edhe për shkak se aty gravitojnë nxënësit nga: Sllatina e Madhe, Sllatina e Vogël, Harilaqi, Henci, Vragolia, Miradia e Epërme dhe Miradia e Ulët si dhe kohëve të fundit edhe nga fshati Bardh i Vogël. Sipas drejtorit të kësaj shkolle z. Tahir Shabani, një fakt brengosës për këtë shkollë është tendenca e rënies së numrit të nxënësve në krahasim me të kaluarën. "Tradicionalisht kemi qenë shkollë e madhe me numër të madh të nxënësve mirëpo kohëve të fundit vërehet rënia e numrit të nxënësve. Kjo rënie ka ardhur si pasojë e lëvizjes së popullsisë drejt qendrave më të mëdha urbane por, për fat të keq edhe për shkak të imigrimit jashtë Kosovës," theksoi z. Shabani.

Edhe objekti i kësaj shkolle ka një histori mjaft interesante pasi që ndërtimi tij është bërë pjesë-pjesë duke u zgjeruar sipas nevojave të shkollës. Rrjedhimisht, kjo shkollë i ka pasur katër faza të ndërtimit-zgjerimit. Faza e parë në periudhën 1924-1928 kur edhe është hapur shkolla për herë të parë. Më pas faza e dytë në vitin 1958, faza e tretë në vitin 1983, dhe faza e katërt në vitin 2000.

Tipari me të cilin krenohet më së shumti drejtori i shkollës është cilësia e punës që zhvillohet aty. Këtë e dëshmon fakti se prindërit e fëmijëve nga fshatrat Bardh i Vogël, Medvec, Vrellë dhe Grabovc janë këmbëngulës që fëmijët e tyre ta vazhdojnë mësimin në këtë shkollë përkundër se kanë opsione të tjera shumë më afër shtëpive të tyre. Për cilësinë e mësimit në këtë shkollë foli edhe arsimtari i gjuhës angleze dhe koordinatori i shkollës, z. Fidan Hasani. Ky i fundit theksoi se tash është viti i shtatë që shkolla organizon gara të brendshme të dijes, të cilat përkojnë me ditën e shkollës. Sipas tij, ky është një aktivitet gjithëpërfshirës, i cili i përmirëson dhe i sfidon nxënësit. Tërë kjo punë ka dhënë rezultat edhe në garat e dijes në nivel komunal dhe kombëtar siç është rasti i garave të organizuara nga Kolegji "Mehmet Akif" në të cilat nxënësit e shkollës kanë arritur të hyjnë në finale në disa lëndë. Kurse, kupat e shumta në zyrën e drejtorit tregojnë se suksesi nuk mungon as në sport.

Në lidhje me hapësirën shkollore z. Shabani thotë se është mjaft i kënaqur pasi që krahas numrit të klasave të mjaftueshme shkolla e ka sallën sportive si dhe fushën e hapur të sportit. Mirëpo, pajisja e shkollës me kabinete dhe mjete të konkretizimit lë shumë për të dëshiruar. "Ne e kemi kabinetin për art si dhe kabinetin e informatikës, të cilin e kemi që nga viti 2000. Këtë kabinet e kemi ripërtërirë rishtas me 28 kompjuterë, 12 laptopë dhe 6 projektorë. Laptopët dhe projektorët janë posaçërisht të nevojshëm për mësimin në paralelet tona të ndara në Harilaq dhe Henc. Mirëpo, në kabinetet e tjera na mungojnë pajisjet e konkretizimit," shtoi z. Shabani.

Në fund z. Shabani pati një porosi për të gjithë shoqërinë e Kosovës e sidomos fakultetet: "Arsimi në Kosovë ka nevojë për kuadro profesionale dhe për këtë përgjegjësia bie mbi fakultete, sepse nëse ne e punësojmë një arsimtar që nuk e ka kualifikimin e duhur atëherë dëmin ua shkaktojmë fëmijëve të cilëve ai do t'iu ligjëroj. Kur i kemi kuadrot e kualifikuara dhe me vullnet për punë atëherë nxënësit do të kenë sukses se nuk bën."

Pyetësor

NËSE DO TË HAJE VETËM NJË USHQIM GJATË TËRË JETËS, CILI DO TË ISHTE AI USHQIM DHE PSE?

Elona Ymeri (12)
Ushqimi që më pëlqen më shumë është gjella me brokoli. Këtë gjellë do të isha në gjendje ta haja tërë jetën sepse ajo është shumë e shëndetshme. Madje unë ua rekomandoj të gjithëve këtë gjellë. E di se fillimisht është e vështirë që të mësohesh me shijen e brokolit por, jam e bindur se me kalimin e kohës do t'ju pëlqej shumë.

Elona Ymeri (12)
The food I like best is broccoli casserole dish. I would eat this dish all my life because it is very healthy. Moreover, I would recommend this dish to everyone. I know that at the beginning it is difficult to get used to the broccoli taste but I am convinced that in time you will like it very much.

Platon Imeri (12)
Unë do të haja vetëm peshk me patate sepse ato janë shumë të shëndetshme dhe mund të përgatiten në mënyra të ndryshme. Pra për mendimin tim peshku dhe patatja janë shumë të shijshme dhe tejet të shëndetshme.

Platon Imeri (12)
I would eat only fish with potatoes because they are very healthy and can be cooked in various ways. So, in my opinion fish and potatoes are very delicious and extremely healthy.

Vesa Piskala (14)
Patatja është një perime e cila ka shumë pak kalori dhe është e pasur me vitaminën C. Po ashtu ajo mund të përgatitet në shumë mënyra të ndryshme. Atë mund ta skuqim, ta ziejmë, ta përdorim për sallatë, supë me patate etj. Besoj se për këtë arsye populli e quan pataten "bukë dhe gjellë". Për këtë arsye nëse do të haja vetëm një ushqim gjatë tërë jetës sime atëherë ajo do të ishte patatja.

Vesa Piskala (14)
Potato is a vegetable very low in calories and rich in vitamin C. It can also be prepared in various ways. They can be fried, boiled, use it in salads, soups, etc. I guess this is the reason why people say that the potato is both "bread and food". This is the reason why if I were to eat only one food my entire life it would be potatoes.

EJHS "BAJRAM CURRI" IN SLLATINË E MADHE

Elementary and Junior High School (EJHS) "Bajram Curri" in Sllatinë e Madhe is considered as the cradle of education for the region of Drenica, Plain of Kosovo and Gollak. This because it was first established in 1924 and the classes at the time were conducted in Serbo-Croatian language. Then in 1941-1942 the classes began to be conducted in Albanian Language. After World War II, many students that had attended this school became teachers in the foregoing regions.

In addition to its importance for the opening of new schools in various areas in Kosovo, this school is also known because it hosts the children from: Sllatinë e Madhe, Sllatinë e Vogël, Harilaq, Henci, Vragoli, Miradi e Epërme and Miradi e Ulët and lately from Bardh i Vogël too. According to the principal of this school, Mr. Tahir Shabani there is a worrying trend in the reduction of students compared to the past. "Traditionally we have been a school with a large number of students. Lately, however, we have noticed a reduction in the number of students. This reduction is a result of the migration of people towards bigger urban centers and, unfortunately, their immigration abroad Kosovo as well," Mr. Shabani highlighted.

The school building has a very interesting history as well because it was constructed and expanded in stages according to the school needs. Consequently, this school had four construction-expansion stages. The first stage took place in 1924-1928, when the school was first opened. The second stage took place in 1958, the third in 1983 and the fourth stage in 2000.

What the principal of this school takes most pride in is the quality of the work conducted there. This is also confirmed by the fact that parents of the children from villages Bardh i Vogël, Medvec, Vrellë and Grabovc insist that their children attend this school despite other options closer to their homes. Mr. Fidan Hasani, English teacher and school coordinator, also spoke about the quality of the teaching in this school. The later, highlighted that this is the seventh year that the school organizes internal knowledge competitions, which coincide with the School Day. According to him, this is an all-inclusive activity that improves and challenges the students. This in turn has yielded good results in the municipal and national knowledge competitions, such as the competitions organized by the "Mehmet Akif" College. In the later the students of this school have managed to qualify in the final round in several subjects. In addition, the many trophies in the principal's office are also a testament that they are successful in sports too.

In relation to the school space Mr. Shabani stressed that he is quite pleased because in addition to sufficient classrooms the school also has a sports hall as well as an open sports field. However, there is a lot to be desired in relation to laboratories and their equipment. "We have laboratories for art and informatics. We have had the latter since 2000 and recently we have resupplied it with 28 computers, 12 laptops and 6 projectors. The laptops and projectors are necessary for the classes in our separate buildings in Harilaq and Hence. However, we do lack the equipment for other laboratories," Mr. Shabani added.

In the end Mr. Shabani appealed to the entire society of Kosovo, in particular the universities: "Kosovo education needs professionals and this responsibility falls on the universities. If we employ a teacher without the proper qualifications then we damage the children that the former will teach. If we have qualified teachers who are willing to work then the students will be successful too."

Questionnaire

IF YOU WERE TO EAT ONLY ONE FOOD DURING YOUR ENTIRE LIFE, WHAT WOULD IT BE AND WHY?

Naman Mehmeti (14)
Ushqimi i vetëm që do të mund ta haja tërë jetën është grosha (fasulja). Kjo sepse ajo kultivohet lehtë, po ashtu edhe gatimi i saj është i lehtë dhe ka shije të mirë. Për më tepër ajo ndihmon edhe në rregullimin e metabolizmit tonë dhe nxjerrjen e toksinave nga trupi ynë.

Naman Mehmeti (14)
The only food I would be able to eat my entire life are beans. This is because they are easy to grow and cooking it is also very easy. Moreover, it helps regulate our metabolism and in the detoxification of our body.

Kandalina Hajdini (14)
Nëse do të haja një ushqim të vetëm gjatë tërë jetës sime do të zgjedhja diçka të shëndetshme siç është kungulli. Unë do të zgjedhja kungullin sepse krahas shijes që më pëlqen ai është edhe shumë i pasur me magnez. Kungulli ndihmon shumë edhe në forcimin e kockave dhe relaksimin e muskujve.

Kandalina Hajdini (14)
If I would have to eat only one food during my entire life I would choose something healthy such as pumpkins. I would choose pumpkins because in addition to tasting great they are also very rich in magnesium. Pumpkins also help in strengthening our bones and relaxing our muscles.

Aldi Krasniqi (13)
Nëse do të duhej të haja vetëm një ushqim do të haja vetëm spageti. Ato janë shumë të shijshme dhe shumë të mira për shëndetin e njeriut e sidomos për dikë që e pëlqen sportin siç e dua unë futbollin. Po ashtu, spagetit mund të bëhen shumë të shijshme me vetëm pak perime.

Aldi Krasniqi (13)
If I would have to choose only one food then it would have to be spaghetti. They are very tasty and great to our health and especially for someone who likes sports like me, namely football. In addition spaghetti's become even better if we add some vegetables.

“SILVER SABRE – 2018-1”

“Silver Sabre”, ky është emri i ushtrimit i cili u zhvillua në fund të muajit prill 2018. Gjatë këtij trajnimi Sekretariati i KSK-së, Agjencia e Menaxhimit Emergjent (AME), Policia e Kosovës (PK), Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK), EULEX-i dhe KFOR-i dëshmuan aftësitë e tyre në reagimin e shpejtë dhe në menaxhimin emergjent pas një fatkeqësi natyrore duke përfshirë edhe përballimin e trazirave të çfarëdo lloji apo përmasash. Tipari kryesor që ra në sy gjatë këtij ushtrimi gjithëpërfshirës ishte profesionalizmi me të cilin pjesëtarët e të gjithë reaguesve gjatë këtij ushtrimi i kryen detyrat e tyre në bashkërendim me njëri-tjetrin duke arritur sukses maksimal në kohën më të shkurtër të mundshme.

Në lidhje me këtë ushtrim z. Nehat Koçinaj, shef i sektorit për planifikim dhe ushtrime pranë AME tha se ushtrimet e tilla janë tepër të rëndësishme pasi që përmes tyre përmirësohet koordinimi dhe reagimi në rast të emergjencave të çfarëdo lloji qofshin ato. “Sigurisht, reagimi gjatë një ushtrimi dhe në një situatë reale dallojnë shumë pasi që niveli stresit është shumë më i madh në situata reale. Për këtë arsye, kurrë nuk mund të jemi të kënaqur me ushtrimet dhe vazhdimisht duhet të synojmë që të përmirësohemi. Sidomos kur bëhet fjalë për koordinimin dhe komunikimin në mes të reaguesve të ndryshëm,” shtoi z. Koçinaj. Ai më tutje vazhdoi duke treguar se në Kosovë aktualisht janë tre reagues. Reaguesit e parë janë niveli lokal ku përfshihen njësitë zjarrfikëse dhe të shpëtimit, Policia e Kosovës dhe shërbimi mjekësor emergjent. Më pas reagojnë FSK-ja në kuadër të mjeteve dhe mundësive të tyre, ndërsa EULEX- dhe KFOR-i i mbështesin popullatën dhe autoritetet lokale.

Skenari i “Silver Sabre” kësaj radhe ishte i ndarë në dy pjesë. Pjesa e parë parashihte testimin e reagimit të shërbimeve emergjente në rast të një fatkeqësie natyrore. Kurse në pjesën e dytë të ushtrimit ishte radha për testimin e aftësive të të gjithë reaguesve në Kosovë në rast të trazirave dhe demonstratave. Kështu, gjatë pjesës së parë të ushtrimit ishin zjarrfikësit dhe pjesëtarët e FSK-së ata që i dëshmuan aftësitë e tyre të reagimit dhe menaxhimit të situatave emergjente. KFOR-i ndihmoi me helikopterë për transferimin e personave të lënduar drejt qendrave mjekësore. Gjatë javës së parë të ushtrimit, ne i vendosëm udhëheqësit, komandantët dhe personelin tonë në një skenar kërkues të fatkeqësisë natyrore, e cila komplikohej me trazira civile si rezultat i një tërmeti prej 6.0 shkallë që e ka goditur Kosovën. Ishte hera e parë sivjet që u përfshinë të gjitha nivelet e Organizatave të Sigurisë së Kosovës, duke ua dhënë mundësinë që të ushtrohet planifikimi dhe ekzekutimi. Të 15-të organizatat e përfshira i dëshmuan aftësitë e tyre gjatë një ushtrimi të suksesshëm 36 orësh.

Në pjesën e dytë të ushtrimit situata ishte ndryshe. Kësaj radhe ishin Policia e Kosovës, EULEX-i dhe KFOR-i të cilët dëshmuan gatishmërinë e tyre për të siguruar një ambient të qentë dhe të sigurt në Kosovë. Për të treguar këto aftësi, ata duhej të përballeshin me një “protestë të dhunshme” si dhe duhej të lironin rrugët nga barrikadat e vendosura nga protestuesit. Duhet theksuar se të dyja palët ishin përgatitur për të krijuar një atmosferë sa më reale. Së pari, Policia e Kosovës përdori mjetet që i ka në dispozicionin e tyre si: topin me ujë, mjetet motorike për depërtimin e barrikadave, shuarësit e lëvizshëm të zjarrit etj. Pas Policisë së Kosovës ishte radha e EULEX-it që të ndërhynte si reagues i dytë në situata të tilla. EULEX-i duhej që të ndërhynte dhe të ndihmonte Policinë e Kosovës për të vënë situatën nën kontroll. Siç edhe pritej, “protestuesit” ishin të vendosur në rezistencën e tyre. Sidoqoftë, edhe kësaj radhe puna në skuadër e forcave të rendit bëri që edhe pika e dytë e qëndresës së protestuesve të merrej nën kontroll. Mirëpo, “protesta” nuk u mbyll me kaq pasi që protestuesit kishin vënë një barrierë të tretë. Për të vënë rregullin edhe në këtë pikë u kërkua ndihma e reaguesit të tretë, gjegjësisht KFOR-it. Përkundër përpjekjeve maksimale për rezistencë, nuk vonoi shumë dhe pjesëtarët e KFOR-it e vunë situatën në kontroll.

Pas përfundimit të ushtrimit, të dyja palët ishin të kënaqura pasi që “protestuesit” i kishin testuar në maksimum kolegët e tyre. Forcat e sigurisë me gjakftohtësi, profesionalizëm e precizitet kishin depërtuar përpara gjithmonë duke respektuar jetën dhe sigurinë e tyre personale por edhe të grupit të demonstruesve para tyre. Në fund nuk mbetet tjetër të themi përpos të rikujtojmë porosinë që z. Koçinaj e tha për të gjithë banorët e Kosovës: “Le të punojmë që të mos kemi raste emergjente reale por, edhe që t’i intensifikojmë ushtrimet dhe t’i specifikojmë ato për të mënjanuar mangësitë apo zbrazësitë në bashkëpunim dhe koordinim për të krijuar një ambient të qetë dhe të sigurt për të gjithë në Kosovë.”

"SILVER SABRE – 2018-1"

"Silver Sabre" is the name of the exercise that was conducted in late April 2018. During this training the Secretariat of the KSC, Emergency Management Agency (EMA), Kosovo Police (KP), Kosovo Security Force (KSF), EULEX, and KFOR showcased their capabilities in rapid reaction and in managing emergencies following a natural disaster which included facing riots of any kind or size. The main feature during this all-inclusive exercise was the professionalism shown by the members of all the responders who by completing their tasks and coordinating with each other achieved maximum success in the shortest possible time.

In relation to this exercise Mr. Nehat Koçinaj, head of planning and exercise sector at the EMA, highlighted that exercises like this are extremely important, because through them the coordination and cooperation in all types of emergency reactions are improved. "Certainly, the reaction during an exercise and in real situations differs a lot, as in the latter the stress level is much higher. Therefore, we can never be completely satisfied with exercises and we continuously strive to improve ourselves. In relation to the coordination and communication between the various responders," Mr. Koçinaj added that currently there are different levels of capabilities when it comes to disaster relief scenarios in Kosovo. The first is the local level, namely firefighting and rescue teams, Kosovo Police and emergency medical services. Next the KSF take actions within their means and capabilities while EULEX and KFOR support the local population and authorities.

The "Silver Sabre" script this time around was divided in two parts. The first part tested the emergency services reactions to natural disasters. Whereas, the second part of the exercise tested the capabilities of all security responders in Kosovo to riots and demonstrations. Consequently, during the first part of the exercise it was the firefighters and KSF members who showed their emergency reaction and management skills. KFOR assisted with helicopters in transferring injured people towards medical centers. In the first week of the exercise, we put our leaders, commanders and staffs in a demanding natural disaster scenario, complicated with a civil disturbance as a result of a magnitude 6.0 earthquake that hit Kosovo. It was the first time this year to involve all levels of the Kosovo Security Organizations providing the opportunity to exercise planning and execution. The fifteen organizations involved proved their capabilities during the successful 36 hour exercise.

The second part of the exercise was conducted differently. It consisted of the Kosovo Police, EULEX, and KFOR showing their readiness in providing a safe and secure environment in Kosovo. In order to show these skills, they had to face a "violent protest" and also had to open the road from barricades set up by protesters. It must be emphasized that both sides had to be prepared to create a very realistic atmosphere. First, the Kosovo Police used all the means at its disposal such as: water cannon, motorized vehicles for breaking barricades, mobile fire extinguishers, etc. After the Kosovo Police it was EULEX's turn as the second responder in such scenarios. EULEX was to intervene and assist the Kosovo Police in controlling the situation. As expected the "protesters" were determined in their resistance. However, again the team work of the security forces resulted in the fall of the second barrier under their control. The "protest" was not over yet though, as the protesters had set up a third barrier. Restoring order at this point required the assistance of the third responder, namely KFOR. Despite maximum resistance efforts, it did not take long before KFOR members took control of the situation.

Once the exercise was over both parties were satisfied, because the "protesters" had tested their colleagues to the maximum. The security forces calmly, professionally and with precision had advanced forward while respecting their own lives and safety as well as the protesters facing them. In the end, the only thing remaining is to repeat the message Mr. Koçinaj had for all the people of Kosovo: "Let's work together to not have emergency situations but, let us also intensify and specify our training in order to avoid any deficiencies in our cooperation and coordination to create a safe and secure environment for all the people in Kosovo."

Na vizitoni në:
Visit us at:

BARBI KUKULLAT MË TË SHTRENJTA NË BOTË

Fëmijët janë pjesë e rëndësishme e jetës sonë. Të gjithë prindërit mundohen shumë që të kujdesen për fëmijët e tyre. Ata duan që fëmijët e tyre të rriten dhe të jetojnë një jetë të lumtur. Janë të gatshëm që t'i arsimojnë dhe t'i bëjnë ata që të fitojnë sa më shumë përvojë që do të jetë e mirëseardhur për ta kur të bëhen të rritur. Prindërit e dinë që kjo moshë është shumë e rëndësishme dhe gjithçka që dinë do të ketë ndikim në personalitetin e tyre në të ardhmen. Prindërit blejnë libra me shumë fotografi apo lodra të ndryshme. Këto lodra janë të bëra në atë mënyrë që t'i argëtojnë fëmijët dhe në të njëjtën kohë të zhvillojnë përvojën e tyre dhe shtojnë vetëdijen. Pra përzgjedhja e lodrës së caktuar për një fëmijë nuk është punë e lehtë. Djem apo vajza, fëmijët kanë interesim të ndryshëm kur vjen fjala te lodrat dhe përzgjedhja e tyre. Djemtë kryesisht duan të luajnë me aeroplanë dhe makina, përderisa vajzat gjithmonë duan të luajnë me kukulla. Ka shumë kompani të famshme që bëjnë kukulla për vajza dhe më e famshmja ndër llojet e kukullave është kukulla Barbi. Këto kukulla janë shumë të shtrenjta dhe janë të bëra nga materiale të çmueshme. Ato vijnë me aksesorë shtesë, sikur set për kozmetikë dhe rroba, etj. Në vazhdim ju sjellim listën e Barbi kukullave më të shtrenjta në botë.

Live Action Christie Barbie Doll

Kjo është kukulla e parë afrikane e cila iu prezantua botës në vitin 1968. Kjo kukull e veçantë nuk ka veshje dhe vishet me veshje të tjera të shumta. Kjo ishte kukulla e parë në botë që mund të lëvizte trupin dhe kishte këmbë dhe duar të lakueshme. Kjo Barbi i takon disa prej kukullave që kanë flokë të gjata. Veçoria më interesante e saj ishte që flokët e saj bëheshin të kuqe me kalimin e kohës gjë që ishte mahnitëse. Ishte e veshur me veshje të mahnitshme ngjyrë portokalli dhe këpucë të shkëlqyera. Çmimi i saj arrinte pothuajse 281 dollarë, që ishte shumë e shtrenjtë për atë kohë kur lodrat e shtrenjta nuk ishin në modë.

Live Action Christie Barbie Doll

This doll was the first African doll which was introduced to the world in 1968. This specific doll has no outfit with it and she wore many other outfits. This was the first doll in the world which can move her body and has flexible legs and arms as well. This Barbie also belongs to few dolls which have long hair. Her most interesting feature was that her hair turns red as the time passes which is amazing. She was dressed up in amazing orange outfit and shiny shoes as well. Its price was almost $281 which is expensive at that time when expensive toys were not in trend.

Pink Splendor

Kjo ka qenë një kukull shumë e bukur e cila është paraqitur në vitin 1996. Kjo kukull është bërë në numër të kufizuar në botë. Ajo ishte kukull shumë e bukur e veshur me fustan ngjyrë rozë nga sateni që e bënte at të duket si princeshë. Flokët e saj ishin të lidhura si duhet dhe në një stil krejtësisht tjetër. Ajo madje mbante edhe disa bizhuteri për tu dukur më tërheqëse. Çmimi për këtë Barbi të bukur ishte afër 900 dollarë.

Pink Splendor

This was a very beautiful doll which was introduced in 1996. This doll was made in a limited edition in the world. It was very beautiful doll and was dressed up in pink satin gown which make her look like a princess. Her hair was tied very properly and in very different style. She was also wearing some jewellery as well to make her look more attractive. The price of this beautiful Barbie was almost $900.

Barbie No.1

Kukulla Barbi Nr. 1 ka qenë e para në botë dhe ajo u prezantua diku në vitin 1959. ajo u ndërtua nga Mattel Toys. Ajo ishte e veshur me rroba të banjës dhe ishte sipas kohës. Ishte me flokë biondë dhe nganjëherë dukej më e errët. Gjithashtu kishte edhe bizhuteri, pra vath dhe kozmetikë. Nuk ishte kukull shumë e bukur, por ishte e veshur shumë bukur. Asokohe çmimi saj ishte afër 8,000 dollarë, që ishte shumë çmim i lartë për vitin 1959 dhe nuk ishte e përballueshme për të gjithë.

Barbie No.1

Barbie No.1 was the first doll made in the world which was introduced in about 1959. It was made by Mattel Toys. It was dressed up in a bathing suit and was according to that time. She has blonde hair and sometimes looks darker. She was also equipped with jewellery like earrings and makeup as well. It was not much beautiful dolly but was dressed up in very hot look. She was sold for almost $8,000 at that time which was very high price tag in 1959 and was not affordable for everyone.

Pink Diamond Barbie

Pink Diamond Barbi ishte disejnuar nga Philipe dhe David Blond. Ishte një lodër shumë e bukur e cila ishte e veshur me fustan pa mëngë të mbuluar me diamante të bukura ngjyrë roze në te. Këpucët që i mbathte

(marr nga: https://www.mostluxuriouslist.com)

MOST EXPENSIVE BARBIE DOLLS IN THE WORLD

Children are an important part of our life. All parents are trying hard to take care of their children. They want them to grow up and live a happy life. They are keen to educate them and make them acquire a lot of experience that would be useful for them when they become adults. They know that this age is very important and that everything that they know will affect their personalities in the future. Parents would buy books full of pictures or any toy. They don't do this just for the sake of entertainment and amusement. These toys are designed in a way to amuse them and at the same time increase their experience and raise awareness. So selecting a certain toy for a child is not an easy feat. Concerning boy and girls, kids have different interests towards the selection of toys to play. Boys mostly love to play with jets and cars while girls always love to play with dolls. Many famous companies are making dolls for the girls and the most famous doll type is the Barbie doll. These dolls are very expensive and are made up of precious material. These dolls come with extra accessories like makeup kit and clothes etc. for the doll. Here is the list of most expensive Barbie dolls in the world.

Stefano Canturi Barbie

Koleksioni më i shtrenjtë i Barbit është punuar nga disenjatori i njohur i bizhuterive i quajtur Stefano Canturi në bashkëpunim me kompaninë prodhuese të kukullave. Kjo kukull ishte bërë me një pamje stilistike me flokë bionde dhe gjatësi të mrekullueshme. Ajo mbante qafore të bukur me diamante të çmuara. Ajo madje mbante edhe unazë të bukur me diamante. Ishte bërë vetëm për gjenerim të parave për fushatën për kancerin e gjirit. Kjo Barbi e shtrenjtë u shit për afër 300,000 dollarë.

Stefano Canturi Barbie

This most expensive Barbie collector was made by famous jewellery designer called Stefano Canturi in collaboration with a toy manufacturing company. This doll was made with very stylish look with blonde hair and beautiful height as well. It was also wearing beautiful necklace made with precious diamonds. She was also wearing beautiful ring made with diamonds. It was only made for generating money for Breast Cancer Campaign. This expensive Barbie was sold for almost $300,000.

The Original Barbie

Ajo ishte kukull shumë e bukur që ishte bërë me pamje moderne për atë kohë. Kjo Barbie ishte paraqitur për herë të parë në vitin 1959. Ishte bërë me veshje shumë moderne dhe me flokë bionde. Mbante një fustan të shkurtër me këpuca me take. Gjithashtu mbante edhe syza dielli që e bënin atë të dukej më me stil. Kjo Barbi origjinale është shitur në ankand për pothuajse 27,450 dollarë.

The Original Barbie

That was very beautiful doll which was made with very modern look at that time. This Barbie was introduced to the world in 1959. It was made with very modern dressing and blonde hair as well. She was wearing a very short dress with heels as well. She was also carrying sunglasses which make her look more stylish. This original Barbie was sold at an auction for almost $27,450.

ishin pa lidhëse dhe ishin të rregulluara me bizhuteri. Lodra ishte e rregulluar edhe me pallto gëzofi që e bënte të dukej më me shkëlqim. Kjo kukull e bukur ishte bërë për t'u shitur në ankand në organizatën MAC AIDS për të gjeneruar para. Në atë ngjarje ajo u shit për pothuajse 15,000 dollarë.

Pink Diamond Barbie

Pink Diamond Barbie was designed by Philipe and David blond. It was very beautiful toy which was dressed up in strapless dress which was whole covered with beautiful pink diamonds on it. The shoes she was wearing were diamond pumps and she was further enhanced with jewellery. The toy was also further enhanced with fur coat and gives her shinier look. This beautiful doll was made to be auctioned in MAC AIDS organization to generate money. It was sold in that event for almost $15,000.

(Source: https://www.mostluxuriouslist.com)

FLORENT ABRASHI

Këngët e tij përmbajnë mesazhe të ndryshme, por më të zakonshmet janë ato mbi dashurinë e përjetshme, mbi triumfin e të mirës kundër të keqes, me një theks të veçantë në mesazhet për të mos reshtur kurrë së kërkuari ëndrrat tona. Ky është FLorent Abrashi, i cili vjen para jush me çiltërsinë dhe thjeshtësinë e një muzikanti të vërtetë të rokut shqiptar.

4U: Çfarë mendoni për skenën muzikore kosovare dhe çka kishit ndryshuar ju?
Florent: Skena muzikore ka ndryshuar shumë, duke sjellë të mira, dhe të këqija; fatkeqësisht mbizotërojnë hite të kopjuara pa gati asnjë vlerë. Ajo çka do të ndryshoja është ligji mbi të drejtat autoriale, ku artistët që vjedhin, të dënohen duke e nxitur kështu kreativitetin që ka munguar deri tash.

4U: Nëse një ditë do të qeverisje botën, çka do të ndryshoje?
Florent: Do bëja gjithçka që

Emri dhe mbiemri: Florent Abrashi
Data e lindjes: 01.01.1989
Vendi i lindjes: Gjakovë
Gjatësia: 1.76
Pesha: 95
Ngjyra e syve: gjelbër
Ngjyra e flokëve: kafe
Ushqimi i preferuar: specat e mbushur
Muzika e preferuar: Rock / Metal
Këngëtari/ja i/e preferuar: David Coverdale / Glenn Hughes
Pija e preferuar: Uji; Vodka Martini
Ngjyra e preferuar: e kuqja
Talenti sekret: vallëzimi latin
Sporti i preferuar: basketbolli
Sportisti i preferuar: Michael Jordan
Cilat janë virtytet tuaja: mirësjellje e tepruar
Stili i veshjes: i thjeshtë, mbizotërojnë ngjyrat e mbyllëta
Kompania incizuese: Dreamhouse Studio
Shpërblimet e fituara: The Voice of Albania 2014

të mos ketë më uri dhe etje në këtë botë, pasi që mendoj se kjo mund të arrihet.

4U: Cilin film e keni shikuar më shumë se një herë?
Florent: Lista e Shindlerit, për vlerat, për mesazhin, për aktrimin dhe muzikën që ky film përcjell. Ky film gjithmonë arrin që të më përlotë.

4U: Cilat janë dëshirat tua për llambën e Aladinit?
Florent: Të gjitha fuqitë e Superman-it, do e zhdukja aftësinë njerëzore për të urryer, të mos ketë më dhimbje.

4U: Në cilën periudhë të historisë kishe pasur dëshirë të jetosh?
Florent: Vitet e 60-ta, kur bota po përjetonte një rilindje në aspektin kulturor, shpirtëror dhe teknologjik, po ashtu edhe muzika kishte një rol të pandashëm asokohe.

4U: Në cilin qytet kishe dëshiruar të jetosh?
Florent: Parisi; për shkak të melankolisë dhe arkitekturës, muzikës dhe djathit fantastik që e ka.

4U: Çka vëren së pari kur je në bisedë me dikë?
Florent: Theksin dhe të folurën, si dhe mundohem të ia qëlloj se nga cili vend është.

4U: Nga çka je frikësuar kur ke qenë i vogël?
Florent: Merimangat e mëdha, fobi e cila është larguar me kalimin e kohës.

4U: A është dashuria vetëm fjalë?
Florent: Jo, dashuria është shumë më shumë se fjalë; është frymëmarrje, është shikim, është prekje, është mendim.

4U: Nuk mund të jetosh pa…?
Florent: Nuk mund të jetoj pa muzikë, jeta është e kotë pa të. Sikur të tentosh të jetosh pa zemër.

4U: A është Xhenifer Lopez sipas mendimit tuaj më e mirë si artiste apo si këngëtare?
Florent: E ka dëshmuar veten edhe si artiste edhe si këngëtare, por mendoj që është më e mirë si këngëtare.

4U: Çka mendon kur je para pasqyrës?
Florent: Që duhet të humb peshë!

4U: Po të mos ishit këngëtar, çka do të ishit?
Florent: Do të isha mësues i vallëzimit, pasioni im qysh nga fëmijëria.

4U: Po të detyroheshe të bëje diçka nga këto, cilën do ta zgjidhje:
1. Të luaje rol negativ në një telenovelë
2. Të lash një grumbull të madh të enëve apo
3. Të hidheshe me litar mbrojtës nga një lartësi e madhe
Florent: Do zgjidhja të hidhesha me litar, sepse e adhuroj ndjenjën e adrenalinës nëpër vena si dhe shpesh ëndërroj sikur fluturoj.

4U: Na tregoni diçka interesante që të tjerët nuk e dinë për ju?
Florent: Kam pasion gjuhët e huaja, flas anglisht, gjermanisht, italisht si dhe kuptoj disa gjuhë tjera, dhe çdo dite mundohem që të mësoj fjalë të reja.

4U: Çfarë preferoni më së shumti nga gardëroba juaj?
Florent: Më së shumti më pëlqejnë pantallonat e zeza, që mund të përdoren si në situata të zakonshme, si në raste të veçanta.

4U: Me cilin person mund ta identifikoni veten nga bota përrallore?
Florent: Superman, me kompleksin e tij për të shpëtuar botën, pasi që shpeshherë e gjej veten duke menduar për probleme shumë të mëdha, përtej meje.

4U: Rekomando një këngë për të kërcyer, një film ku mundesh të shfryhesh nga të qajturit dhe një baladë që mund të dëgjohet me dekada?
Florent: Kënga: la vida es un carnaval, filmi: Lista e Shindlerit, balada: Looking for love - Whitesnake

4U: Çfarë mendoni për të rinjtë e Kosovës dhe cila është porosia juaj për ta?
Florent: Të rinjtë e Kosovës janë para një udhëkryqi shume problematik, dhe ne si artistë duhet të jemi shumë të kujdesshëm se në cilin drejtim i shtyjmë, pasi që ne ndikojmë ose prekim gjenerata të tëra. Porosia është që të mundohen të krijojnë personalitete të bazuara në kujtime të vërteta, jo në një jetë të rrejshme të ndërtuar në mediat sociale.

FLORENT ABRASHI

His songs contain different messages, but the most common are those on eternal love, on the triumph of good against evil, with a special emphasis on the messages to never stop seeking our dreams. This is Florent Abrashi, who comes before you with the sincerity and simplicity of a true Albanian rock musician.

4U: What do you think about the Kosovan music scene and what would you change?
Florent: The musical scene has changed a lot, bringing both good and bad; unfortunately copied hits without any value are dominant. What I would change is the copyright law punishing the artists who steal, thus fostering the creativity that has been missing.

4U: If one day you would govern the world, what would you change?
Florent: I would do everything to eradicate hunger and thirst in this world, as I think it is possible to achieve this.

4U: Which movie have you watched more than once?
Florent: Shindler's List, because of the values, the message, acting and the soundtrack. This movie always makes me break in tears.

4U: What are your wishes for the Aladdin's lamp?
Florent: All Superman's powers; I would eradicate pain and the human's ability to hate.

4U: In which period of history would you want to live?
Florent: In the 1960s, when the world was experiencing a cultural, spiritual, and technological resurgence, music also had an inseparable role in the world at the time.

4U: In which city would you want to live in?
Florent: Paris; due to its melancholy and architecture, music and fantastic cheese.

4U: What do you notice when you first converse with someone?
Florent: Speaking accent, and I try to figure out from which country the person is from.

4U: What did you fear when you were little?
Florent: Big spiders, a phobia that has gone away over time.

4U: Is love just words?
Florent: No, love is far more than words; it is breathing, a look, a touch, a thought.

4U: One cannot live without ....?
Florent: I cannot live without music, life is futile without it. Just like trying to live without a heart.

4U: Iin your opinion is Jennifer Lopez a better actor or singer?
Florent: She is a proven actor and singer, but I think she is better as a singer.

4U: What do you think when you stand in front of the mirror?
Florent: That I should lose weight!

4U: If you were not a singer, what would you be?
Florent: I would be a dance teacher, my childhood passion.

4U: If you were forced to do one of the following, which would you pick?
1. To play a villain in a telenovela
2. To wash a large pile of dishes or
3. Bungee jumping from a high altitude
Florent: I would bungee jump, because I adore the adrenaline rush in the veins and I often dream of flying.

4U: Tell us something interesting that the others do not know about you?
Florent: Foreign languages are my passion, I speak English, German, Italian and I understand a few other languages, and every day I try to learn new words.

4U: What do you prefer the most from your wardrobe?
Florent: I mostly fancy black pants, because I can wear them in casual and in special occasions.

4U: Which character from fairy tales would you like to be identified with?
Florent: Superman, with his drive to save the world, as I often find myself thinking about big problems beyond me.

4U: Recommend us a song to dance, a movie to cry and a ballad to listen for decades?
Florent: Song: la vida es un carnaval; Movie: Shindler's List; Ballad: Looking for love - Whitesnake

4U: What do you think about Kosovo's youth and what is your message for them?
Florent: Kosovo's youth are facing a very problematic crossroad, and we, the artists, should be very careful in what direction we are pushing them, as we influence entire generations. The message is to try to create personalities based on true memories, and not on a false life built on social media.

Name and Surname: Florent Abrashi
Date of birth: 01.01.1989
Place of birth: Gjakova
Height: 1.76
Weight: 95
Eye color: green
Hair color: brown
Favorite food: stuffed peppers
Favorite music: Rock / Metal
Favorite singer: David Coverdale / Glenn Hughes
Favorite drink: Water; Vodka Martini
Favorite color: red
Secret talent: Latin dance
Favorite sports: basketball
Favorite sportsman: Michael Jordan
Virtues: excessive courtesy
Dress style: Plain, dark colors dominate
Recording company: Dreamhouse Studio
Awards: The Voice of Albania 2014

KUJDES MINAT!

z. Ben Remfrey

Më 8 dhjetor 2005, Kombet e Bashkuara vendosën që të shpallin 4 prillin si Ditën Ndërkombëtare për Vetëdijesim për Minat. Qëllimi i shënimit të kësaj dite është që të rris vetëdijesimin në lidhje me kërcënimin që e paraqesin minat ndaj sigurisë, shëndetit dhe jetëve të popullsisë civile. Fëmijët në veçanti janë në rrezik që të mos kenë njohuri mbi minat dhe mjetet e tjera të pashpërthyera (UXO). Qëllimi i shënimit të Ditës Ndërkombëtare për Vetëdijesim për Minat është që të nxis qeveritë anë e kënd botës që të zhvillojnë programe për pastrimin e minave.

Kosova, ashtu si edhe të gjitha vendet e tjera që kalojnë nëpër konflikte të armatosura, përballet me kërcënimin nga minat dhe objektet e tjera të pashpërthyera. Për këtë arsye, më 4 prill në ambientet e qendrës "Mine Action and Training (MAT) Kosovo" u mblodhën të gjithë aktorët që janë aktiv në zhvillimin e programeve të deminimit në Kosovë, duke filluar nga KFOR-i, Policia e Kosovës, Forca e Sigurisë së Kosovës si dhe Organizatat Joqeveritare si HALO Trust dhe Ndihma Popullore Norvegjeze - NPN (Norsk Folkehjelp) si dhe pjesëtarët e nikoqirit MAT Kosovo. Krahas mysafirëve dhe gazetarëve të shumtë këtë aktivitet e vizitoi edhe Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të KFOR-it Gjeneral Brigade Lawrence Randy Powell. Me këtë rast, të gjithë të pranishmit patën rastin që të njiheshin më për së afërmi me punën e kryer deri më sot në pastrimin e territorit të Kosovës nga këto objekte shpesh vdekjeprurëse.

Sipas raportimit që u bë me këtë rast nga pjesëtarët e FSK-së në Kosovë sot ekzistojnë rreth 49 zona të minuara dhe 49 zona ku gjenden mbetje të bombave kasetë. Kurse ata i kanë pastruar rreth 1.958.185 metra katrorë. Po ashtu, duke filluar nga viti 2010 FSK-ja ka mbajtur ligjërata rreth minave në gjithsejtë 700 shkolla për rreth 35000 nxënës. Në anën tjetër, përfaqësuesit e organizatës HALO Trust raportuan se duke filluar nga viti 1999 ata i kanë pastruar rreth 15.751.000 metra katror. Si rezultat i këtyre veprimeve janë gjetur dhe janë shkatërruar 40.751 mjete të rrezikshme.

Ajo që duhet të kuptohet është se kërcënimi nga minat dhe objektet e pashpërthyera është i pranishëm në tërë Kosovën. Për këtë arsye duke filluar nga viti 2016 NPN ka filluar të punojë në pastrimin e këtyre objekteve të rrezikshme edhe në pjesën veriore të Kosovës. Fillimisht, aktivitetet e deminimit atje u zhvilluan nga një ekip nga Bosnja mirëpo, tani kjo organizatë i ka trajnuar 24 persona, 12 shqiptarë dhe 12 serb, të cilët janë të ndarë në dy ekipe etnikisht të përziera. Sipas z. Samir Emini, ekspert nga Bosnja dhe Hercegovina, situata në veri është shumë e komplikuar pasi që fillimisht ka pasur informacione se atje ka vetëm mbetje të bombave kasetë. Mirëpo, pas punës në terren është vërtetuar se në komunat e Zubin Potokut dhe Leposaviqit ka edhe fusha të minuara.

Z. Ben Remfrey, drejtori menaxhues i Kompanisë Praedium Consulting Malta, pjesë e së cilës është edhe qendra MAT Kosovo, e cila është e specializuar në trajnimet për EOD (Shkatërrimin e Armëve Shpërthyese) dhe deminim, theksoi se është tejet e rëndësishme që të promovohet dhe të punohet në pastrimin e zonave të rrezikuara nga minat dhe objektet e pashpërthyera dhe që ato zona të kthehen në përdorim të popullatës. Hapi i parë dhe më i rëndësishëm në këtë drejtim është edukimi për minat dhe objektet e pashpërthyera. "MAT Kosovo është shkolla numër një në botë për EOD dhe deminim. Për këtë arsye në këtë qendër vijnë njerëz nga mbarë bota për t'u trajnuar për pastrimin e minave dhe objekteve të pashpërthyera. Sot, në shumë vende të botës kosovarët janë udhëheqës të programeve të deminimit. Prandaj, rinia e Kosovës duhet ta kuptojnë se sa të rëndësishëm janë për mbarë globin," shtoi mes të tjerash z. Remfrey. Ai në fund i porosit të gjithë njerëzit në Kosovë që të angazhohen në promovimin e sigurisë, mirëkuptimit dhe edukimit për minat dhe objektet e pashpërthyera.

Të gjithë ekspertët e pranishëm në këtë aktivitet patën një porosi për të rinjtë anekënd Kosovës – në rast se dilni në natyrë tregohuni të kujdesshëm dhe informohuni nëse ka rreziqe nga minat dhe objektet e pashpërthyera. Respektoni shenjat e rrezikut. Ç' është më e rëndësishmja nëse hasni objekte të dyshimta mos i prekni ato por, sa më parë lajmëroni Policinë e Kosovës, FSK-në apo KFOR-in.

NUMRI I TELEFONIT FALAS
192 ose 112

BEWARE OF MINES!

On October 8th, 2005, the United Nations declared the 4th of April to be ***International Mine Awareness Day***. The purpose of this day is to increase the awareness of the threat mines pose against the security, health, and lives of the civilian population. Children are especially at risk of not having awareness about mines and other unexploded ordinances (UXO). The goal of ***International Mine Awareness Day*** is to encourage governments across the world to develop mine clearing programs.

Like many other countries that have gone through armed conflict, Kosovo faces the threat of mines and other unexploded ordinances (UXO). Because of this, on April 4th, 2018 all involved in conducting demining programs in Kosovo such as KFOR, Kosovo Police (KP), Kosovo Security Forces (KSF) and Non-governmental Organizations like HALO Trust and Norwegian People's Aid (NPA) and members of the host "Mine Action and Training (MAT) Kosovo" converged at the facilities of MAT Kosovo in Peja. In addition to many guests and journalists this activity was also visited by HQ KFOR Chief of Staff Brigadier General Lawrence Randy Powell. All those present at this event had the chance to get a close look at the work completed so far in clearing the Kosovo territory from these lethal objects.

According to the briefing from the KSF members there are around 49 mined zones and 49 zones with remnants of cluster bombs. The KSF have cleared 1.958.185 square meters so far. Starting in 2010 KSF has conducted mine awareness lectures in 700 schools for around 35.000 students. On the other hand, representatives of HALO Trust reported that since 1999 they have cleared 15.751.000 square meters, resulting in 40.751 UXOs been found and destroyed.

What we need to understand is that the threat of mines and UXOs is present throughout Kosovo. Beginning last year the NPA has been working on clearing these dangerous objects in Northern Kosovo. Initially the demining activities were conducted by a team from Bosnia and Herzegovina. This organization has now trained 24 people, 12 Albanian and 12 Serbian who are divided in two ethnically mixed teams. According to Mr. Samir Emiri, an expert from Bosnia and Herzegovina, the situation in the north is very complicated, as the initial reports claimed that there were only remains of cluster bombs. After work started in the field it was confirmed that there are also mine fields in Zubin Potok and Leposaviq Municipalities.

Mr. Ben Remfrey is the managing director of Praedium Consulting Malta Company which is part of MAT Kosovo that specializes in EOD and demining training. Mr. Remfrey highlighted that it is very important to promote and work in clearing the areas endangered by mines and UXOs to make the areas safe for the population. The first and most important step towards this is education on mines and UXOs. Mr. Remfrey said "MAT Kosovo is the world's number one school for EOD and demining. This is why people from around the world come to our center to train on clearing mines and UXOs. Today, Kosovars lead demining programs in many countries around the world. Therefore, the Kosovo youth should understand how important they are globally." He also appealed to all the people in Kosovo to engage in promoting security, understanding and education about mines and UXOs.

#TOGETHER AGAINST MINES

All the experts attending this activity have a message for the youth of Kosovo – if you are out in nature be careful and be informed that there are risks from mines and UXOs. Be aware of the danger signs. It is possible that you can find unknown mines/UXOs without warning signs. Therefore it is important to understand if you encounter these suspicious objects do not touch them, educate your family and friends so they can be more careful and aware, and if you encounter something suspicious, immediately notify the Kosovo Police, KSF or KFOR.

FREE PHONE NUMBER 192 or 112

Na vizitoni në: Visit us at:

Kafshët më të lezetshme në botë

Një video incizim i një maceje ose qeni mjafton që të na bëjë të gjithë ne të themi 'ohh' dhe si macet dhe qenët, ka edhe shumë kafshë të tjera të lezetshme në botë që zgjojnë kënaqësi duke i shikuar. Disa prej tyre janë me gëzof, disa me gjemba dhe disa me pupla, por që të gjitha e kanë një gjë të përbashkët dhe kjo është se ato janë kafshët më të lezetshme në botë.

Macja persiane

Macja persiane është një mace e njohur për të gjithë ata që janë adhurues macesh, apo janë mbarështues ose pronarë të një maceje. Macja persike në mesin e maceve është një racë e bukur macesh dhe njihet për natyrën e saj miqësore. Qoftë për shkak të syve të saj të mëdhenj, ose për shkak të gëzofit të saj të gjatë dhe si mëndafshi ose edhe natyrës së saj lozonjare, macja persiane zë vendin e parë në çdo kategori të treguesit të të qenit i lezetshëm. Njëkohësisht ajo është shumë e lehtë për t'u mbajtur dhe nuk ka nevojë për vëmendje të vazhdueshme.

Persian cat

The Persian cat is a well-known name for anyone who is a cat lover, owner or breeder. The Persian is one of the beautiful cat breeds among cats and is known for its friendly nature. Be it the large eyes, the long silky fur or the playful nature, the Persian scores high in every category on the cuteness index. It is also very easy to maintain and does not require constant attention.

Lepuri

Çdokush që ka parë një lepur, definitivisht është prekur nga pamja mahnitëse e kësaj kafshe. Lepuri ka një feçkë të lëvizshme, veshë të gjatë, dhëmbë të përparmë të lezetshëm dhe sy të bukur, duke e bërë atë një nga kafshët më të lezetshme që një person mund t'a ketë si kafshë shtëpiake. Ndoshta për këtë arsye, këto kafshë janë një nga kafshët shtëpiake më të popullarizuara në botë. Këta topa leshi kanë një sërë ngjyrash dhe të vegjlit e tyre janë mahnitës.

Rabbit

Anyone who has seen a rabbit has definitely been won over by the stunning looks of this animal. It has a twitchy snout, long ears, cute front teeth and beautiful eyes making it one of the cutest animals one can have as a pet. Perhaps because of this reason, these animals are one of the most popular pets in the world. These fur balls come in a large range of colours and patterns and their babies are a sight to behold.

Pomeranezi

Pomeranezi është e njëjta për qentë ashtu siç persianet janë për macet. Ashtu si macet persiane, kjo racë e qenit është një nga qentë më të bukur që mund të kenë pronarët dhe gjithashtu është qeni që më së shumti shumohet. Pasi që janë një nga kafshët më të lezetshme dhe janë qenë shumë të lehtë, ata gjithashtu njihen si qenë lodra. Gëzofi i tyre i trashë, me bisht pushtarak dhe me fytyrë të ngjashme sikurse arushë i bënë ata manarë shumë të dëshiruar.

Pomeranian

The Pomeranian is to dogs what the Persian is to cats. Like the Persian cat, this dog breed is one of the most beautiful dog breeds among owners and is also one of the most widely bred dogs. Since they are one of the cutest animals and are very easy going dogs, they are also known as toy dogs. Their thick fur, fluffy tail and teddy bear like face make them very desirable pets.

Panda e kuqe

Kjo kafshë shumë e rrallë gjendet vetëm në pjerrësirat e Himalajeve dhe ata pak persona që e kanë pasur rastin ta shohin vërtetojnë bukurinë e saj. Edhe pse quhet panda, nuk është fare e afërt me kushëririn bardhë e zi. Panda e kuqe ka gëzof të kuq të mbyllët kah kafja me shenja të bardha, bisht leshator dhe këmbë të shkurtra.

Red Panda

This extremely rare animal is found only on the slopes of the Himalayas and the few who have seen this animal will testify to its cuteness. Though it is called a panda, it is not very closely related to its black and white cousin. The Red Panda has dark reddish to brown fur with white markings, a bushy tail, and short legs.

Cutest animals in the world

A video of a cat or a dog is enough to make all of us go 'aww' and like cats and dogs, there are many other cute animals in the world that are a treat to watch. Some are furry, some spiny and some feathery but there is one thing in common - they are the cutest animals in the world.

Dhelpra arktike

Dhelpra arktike është një kafshë që i është përshtatur shumë mirë kushteve të mbijetesës në klimë ekstreme në tokë, por përkundër kësaj ajo është një nga kafshët më të bukura në botë. Dy herë në vit e ndërron gëzofin dhe është një nga kafshët që e ndryshon ngjyrën sipas stinës. Në dimër ajo e ka gëzofin jashtëzakonisht të trashë dhe krejtësisht të bardhë, përderisa në dimër gëzofi është i kaft dhe më i rrallë.

Arctic Fox

The Arctic Fox is an animal that is very well adapted to surviving in one of the most extreme climates on Earth but despite this is one of the cutest animals in the world. It sheds its fur twice a year and one of the colour changing animals depending on the season. In winter, the fur is extremely thick and pure white in colour while the summer coat is brownish and sparse.

Koala

Duket sikurse një arush pelushi, që e bënë si njërën nga kafshët më të bukura, përkundër që nuk ka asnjë lidhje me familjen e arushave. Koala kohën kryesisht e kalon në drunjë dhe ushqehet me gjethe të drurit të eucalyptus-it. Meqë dieta e sajë përmban mjaft lagështi, nuk ka nevojë që të pijë ujë shtesë për mbijetesë. Në fakt, vet fjala 'Koala' donë të thotë 'pa ujë'.

Koala

It looks like a teddy bear, making it one of the cutest animals, though it is not even remotely related to the bear family. The Koala spends most of its time in trees and feeds on leaves of the Eucalyptus plant. Since its diet contains enough moisture, it does not need to drink additional water to survive. In fact, the word 'Koala' itself means 'no water'.

Bufi xhuxh

Bufi nuk është diçka që do ta përshkruani si i lezetshëm, por bufi xhuxh është një shembull se si ky mendim mund të ndryshojë. Sikurse edhe shumica e bufëve, edhe ky buf ka sy të mëdhenj dhe të kombinuar me trup të vogël, me shenja të bukura në krahë që e bëjnë atë një nga kafshët më të lezetshme. Këta bufë janë gjithashtu grabitqarë vrasës dhe ekspert në gjuajtjen e lepujve, brejtësve dhe kafshëve të vogla gjatë natës.

Pygmy Owl

An owl is not something you would describe as cute, but the Pygmy Owl is sure to turn this conception on its heels. Like most other owls, this owl too has large eyes and combined with the small body, beautiful patterns on the wings make it one of the cutest animals. These owls are also deadly predators and expertly hunt rabbits, rats and other small animals at night.

Pinguini

Një pinguin me ecje duke u shalakatur në akull me gjasë është një nga pamjet më të bukura që do të mund ta shihni ndonjëherë dhe këto shpezë jofluturuese, për shkak të të ecurit sikurse njeriu, janë një nga kafshët më të lezetshme në botë. Madje edhe më të lezetshëm janë pinguinët e vegjël pasi që disi gjatësia e vogël i bënë ata edhe më të këndshëm. Këta pinguin të vegjël kanë nevojë për kujdesin e prindërve pasi që mungesa e ushqimit i vret.

Penguin

A penguin waddling in the ice is perhaps one of the best sights you will ever see and these flightless birds, because of their human-like gait, are one of the cutest animals in the world. Even cuter than average Penguins are little penguins as their small size somehow adds to their cuteness. These little penguins need to be looked after by their parents and will die in the absence of food.

for 4U
for You

Florent ABRASHI

Lu over the wall

LU OVER THE WALL

Rolet: Michael Sinterniklaas, Stephanie Sheh
Regjia: Masaaki Yuasa
Skenari: Masaaki Yuasa

Përmbajtja

Një tregim klasik familjarë për një sirenë të vogël që vjen në breg për t'iu bashkuar një grupi të rokut të shkollës së mesme për t'i bërë të famshëm. Kai është i talentuar por i pa vendosur, që kalon ditët me turi të varur në një fshat të vogël duke peshkuar pasi familja e tij largohet nga Tokio. Kënaqësia e tij e vetme është ngarkimi i këngëve në internet të cilat ai vet i shkruan. Kur shokët e klasës e ftojnë të luaj në taste në grupin muzikor të tyre, sezoni i ushtrimeve të tyre sjell një mysafir të papritur: Lu, një sirenë e re, flatrat e së cilës kthehen në këmbë kur ajo e dëgjon ritmin dhe këndimi i së cilës i detyron njerëzit që të vallëzojnë – deshën apo jo. Përderisa Kai kalon më shumë kohë me Lu, ai e gjen mënyrën se si t'i tregojë atë që në të vërtetë mendon dhe kështu fillon të formohet një lidhje. Por, që nga kohërat e lashta, njerëzit në fshat kanë besuar se sirenat sjellin fatëkeqësi andaj shumë shpejt nisin telashet në mes të Lu dhe fshatarëve, duke e sjell fshatin në një rrezik të madh.

LU OVER THE WALL

Cast: Michael Sinterniklaas, Stephanie Sheh
Director: Masaaki Yuasa
Screenwriter: Masaaki Yuasa

Synopsis

A family-friendly take on the classic fairy tale about a little mermaid who comes ashore to join a middle-school rock band and propel them to fame. Kai is talented but adrift, spending his days sulking in a small fishing village after his family moves from Tokyo. His only joy is uploading songs he writes to the internet. When his classmates invite him to play keyboard in their band, their practice sessions bring an unexpected guest: Lu, a young mermaid whose fins turn to feet when she hears the beats, and whose singing causes humans to compulsively dance - whether they want to or not. As Kai spends more time with Lu, he finds he is able to tell her what he is really thinking, and a bond begins to form. But since ancient times, the people in the village have believed that mermaids bring disaster and soon there is trouble between Lu and the townspeople, putting the town in grave danger.

TULLY

Rolet: Charlize Theron, Mackenzie Davis, Ron Livingston, Mark Duplass
Regjia: Jason Reitman
Skenari: Diablo Cody

Përmbajtja

Marlos, një nëne me tre fëmijë, duke pëfshirë edhe një bebe të porsalindur, i dhurohet një dado e talentuar e natës nga vëllai i saj. Pas hezitimit fillestar për shkak të ekstravagancës, Marlo fillon të formojë një lidhje të veçantë me dadon e re të matur, befasuese dhe nganjëherë sfiduese të quajtur Tully.



TULLY

Cast: Charlize Theron, Mackenzie Davis, Ron Livingston, Mark Duplass
Director: Jason Reitman
Screenwriter: Diablo Cody

Synopsis

Marlo, a mother of three including a new-born, is gifted a night nanny by her brother. Hesitant to the extravagance at first, Marlo comes to form a unique bond with the thoughtful, surprising, and sometimes challenging young nanny named Tully.

THE UNTITLED DEADPOOL SEQUEL

Rolet: Ryan Reynolds, Zazie Beetz, Josh Brolin, Morena Baccarin, Brianna Hildebrand, Jack Kesy
Regjia: David Leitch
Skenari: Rhett Reese & Paul Wernick

Përmbajtja

Pasi i mbijeton një sulmi vdekjeprurës të gjedhëve, një kuzhinier kafeneje i shfytyruar përpiqet të përmbushë ëndrrën e tij për t'u bërë baristi më hot i Mayberry ndërsa mundohet të mësojë të përballojë ndjenjën e humbur të shijes. Duke kërkuar për të rifituar fillin e tij për jetën, si dhe një kondensator fluksi, Wade duhet të luftojë ninxhat, jakuzat dhe një grup të qenve agresiv seksualisht, teksa udhëton nëpër botë për të zbuluar rëndësinë e familjes, miqësisë dhe shijes - një shije të re për aventura dhe për të fituar titullin e filxhanit të lakmuar të kafesë Dashnori më i Mirë në Botë.

THE UNTITLED DEADPOOL SEQUEL

Cast: Ryan Reynolds, Zazie Beetz, Josh Brolin, Morena Baccarin, Brianna Hildebrand, Jack Kesy
Director: David Leitch
Screenwriter: Rhett Reese & Paul Wernick

Synopsis

After surviving a near fatal bovine attack, a disfigured cafeteria chef struggles to fulfil his dream of becoming Mayberry's hottest bartender while also learning to cope with his lost sense of taste. Searching to regain his spice for life, as well as a flux capacitor, Wade must battle ninjas, the yakuza, and a pack of sexually aggressive canines, as he journeys around the world to discover the importance of family, friendship, and flavour - finding a new taste for adventure and earning the coveted coffee mug title of World's Best Lover.

THE SON OF BIGFOOT

Rolet: Pappy Faulkner, Chris Parson, Terrence Stone, Lindsay Torrance, Joey Lotsko
Regjia: Ben Stassen, Jeremy Degruson
Skenari: Callan Brunker, Bob Barlen

Përmbajtja

Adoleshenti i panjohur Adam nisë një përpjekje epike dhe të guximshme për të zbuluar misterin e babait të tij të humbur, vetëm për të kuptuar se ai nuk është askush tjetër përveç Bigfoot-it legjendar! Ai është fshehur thellë në pyll për vite me radhë për të mbrojtur veten dhe familjen e tij nga HairCo., një korporatë gjigande e etur për të bërë eksperimente shkencore me ADN-në e tij të veçantë. Ndërsa babai dhe djali fillojnë të rikuperojnë kohën e humbur, Adam zbulon shpejt se edhe ai është i talentuar me superfuqitë përtej imagjinatës së tij. Por ata nuk e dinë që, HairCo. është prapa tyre pasi gjurmët e Adamit i kanë çuar te Bigfoot!

THE SON OF BIGFOOT

Cast: Pappy Faulkner, Chris Parson, Terrence Stone, Lindsay Torrance, Joey Lotsko
Director: Ben Stassen, Jeremy Degruson
Screenwriter: Callan Brunker, Bob Barlen

Synopssis

Teenage outsider Adam sets out on an epic and daring quest to uncover the mystery behind his long-lost dad, only to find out that he is none other than the legendary Bigfoot! He has been hiding deep in the forest for years to protect himself and his family from HairCo., a giant corporation eager to run scientific experiments with his special DNA. As father and son start making up for lost time, Adam soon discovers that he too is gifted with superpowers beyond his imagination. But little do they know, HairCo. is on their tail as Adam's traces have led them to Bigfoot!

PUNONI FORT PËR T'I REALIZUAR ËNDRRAT E JUAJA!

Një ndër hapat e parë drejt suksesit për të gjithë ne është që të zbulojmë se çfarë na pëlqen që të bëjmë dhe më pas të angazhohemi dhe të punojmë maksimalisht drejt këtij qëllimi. Olt Kondirolli është vetëm 15 vjeçar, mirëpo mosha e tij e re nuk e ka penguar atë aspak që ta gjejë se çfarë dëshiron të bëhet. Pasi ushtroi disa vjet basketboll, Olti vendosi që të provonte veten në not. Shumë shpejt nën udhëheqjen e trajneres së tij, ish notares dhe kampiones znjsh.Daulina Osmani, Olti filloi të zbulonte talentin e tij në këtë sport. Që atëherë kanë kaluar pak më shumë se dy vite, kurse Olti tashmë ka filluar të shijoj suksese edhe në arenën kombëtare dhe ndërkombëtare të notit. Suksesi i tij i fundit erdhi në Mitingun e XVII Ndërkombëtar "Sarajevës me Dashuri 2018" i cili u mbajt nga data 31 mars deri më 1 prill 2018. Në këtë miting Olti garoi në disa disiplina në kategorinë C për grupmoshat 2002-2003. Në mesin e rezultateve mjaft mbresëlënëse shquhet vendi i tretë, i cili i siguroi atij medaljen e bronztë, në disiplinën 100 metra not i lirë (krol) me rezultatin 1 minutë e 53 të qindtat e sekondës.

S'do mend se mungesa e infrastrukturës përkatëse, gjegjësisht pishinave olimpike (50 metra) vazhdon të jetë një prej pengesave të mëdha me të cilën përballen të gjithë notarët tanë pasi që ata të gjithë duhet të ushtrojnë në pishinat gjysmë olimpike (25 metra). Përkundër kësaj Olti është i bindur se puna e palodhshme do të shpërblehet dhe se ai do të arrijë të kap majat e këtij sporti. Për ta bërë këtë, Olti aktualisht i zhvillon shtatë seanca stërvitore në javë. Pesë seanca në not nga dy orë dhe 2 seanca të tjera nga një orë e gjysmë në palestër për fitnes. Mirëpo, ka raste kur ai i zhvillon deri në nëntë seanca stërvitore në javë. "Besoj se e kam aftësinë që të mund të fitoj më shumë se një medalje të artë olimpike, gjithmonë nëse vazhdojë të punoj edhe më shumë sepse puna dhe vullneti e përcaktojnë suksesin," theksoi Olti. Ai më tutje shpjegoi se gjatë një dite mund të notojë deri në 6 kilometra distancë.

Një tjetër problem me të cilin përballet Olti sikurse edhe shumë sportistë të tjerë është mungesa e përkrahjes financiare, përkundër rezultateve të dalluara në të gjitha garat në të cilat ai ka marrë pjesë deri tani. Sipas tij sporti i notit në nivelet garuese është mjaft i kushtueshëm. Në fakt pajisjet e një notari si ai mund të kushtojnë 500 deri në 800 euro. Pa e përmendur këtu dietën shumë të pasur e cila sipas Oltit ka rol kyç në suksesin e çdo sportisti. "Dieta është tejet e rëndësishme. Ajo është kushti i dytë për të arritur suksesin pas punës në stërvitje. Shprehur në terma më praktik ajo përbën 50-60% të suksesit," shtoi Olti. Për këtë arsye ai e ka një falënderim të veçantë për prindërit e tij të cilët e kanë mbështetur atë në realizimin e ëndrrës së tij: medaljes olimpike në not.

Kur e lutëm që të veçonte ndonjë prej rezultateve të tij krahas arritjeve në mitingun e Sarajevës Olti veçoi edhe suksesin që e tregoi vitin e kaluar në Kampionatin Mbarëkombëtar në Durrës. Kjo sepse aty ishte hera e parë ku ai ka arritur që të vendos një rekord të ri për gjeneratat 2003-2004 në garën 50 metra krol. Një arritje tjetër shumë e rëndësishme është se deri tani Olti i ka arritur tërë këto suksese pa i ulur rezultatet e tij në shkollë. Ai vazhdon të jetë nxënës shembullor përkundër se siç u shpreh e ka mjaft të vështirë që krahas notit të gjej kohë edhe për të mësuar dhe për të qenë me shoqërinë e tij. Mirëpo, edhe pse noti ka prioritet për të deri tani ai ia del që të jetë i shkëlqyer në të gjitha frontet. Sipas tij, kjo është e mundur sepse nëse e gjen një aktivitet që e do me shpirt sikurse e do ai notin, atëherë asgjë nuk është e vështirë. Në këtë rast angazhimi dhe puna nuk do të shkojnë huq dhe nuk do të ketë kufi për arritjet tona. Kurse, vet Olti dëshiron që të arrij maksimumin e aftësive të tij dhe të bëhet një notar si Michael Phelps.

WORK HARD TO MAKE YOUR DREAMS COME TRUE!

One of the first steps towards success for all of us is to find out what we like to do and then engage and work hard towards that goal. Olt Kondirolli is only 15 years old, but his young age has not prevented him at to find out what he wants to be. After training several years basketball Olti decided to try himself in swimming. Soon enough, under the guidance of his coach, former swimmer and champion Ms. Daulina Osmani, Olti started discovering his talent in this sport. It has been just over two years since then but Olti has already started enjoying success in the national and international swimming arena. His last achievement came at the XVII International Meeting "To Sarajevo with Love 2018" that was held from March 31st to April 1st, 2018. In this meeting Olti competed in several disciplines in C category for the 2002-2003 generations. Among his very impressive results is the third place and bronze medal in 100 meters free style, which he finished in 1 minute and 53 hundreds of the second.

The lack of the respective infrastructure, namely Olympic swimming pools (50 meters) remains one of the great obstacles that all our swimmer face, as they have to train in semi Olympic (25 meters) swimming pools. Despite this Olti is convinced that his tireless work shall be rewarded and one day he will reach the top of this sport. To do this, Olti currently has seven training sessions per week: five two hour swimming sessions and two more 1.5 hour fitness sessions at the gym. However, there are cases when he has up to nine training sessions per week. "I believe I have what it takes to win more than one gold Olympic medal, provided that I continue working even harder because, work and will determine success," highlighted Olti. He went on stressing that during one day he may swim up to 6 kilometers distance.

Another problem that Olti, just as many other athletes in Kosovo, faces is lack of financial support despite his distinguished results in all the competitions he has participated so far. According to him competitive swimming is very expensive. In fact a swimmers equipment cost somewhere between 5 and 800 euros. Without taking here in consideration the very rich diet that is required, which Olti claims is of key importance to the success of all athletes. "The diet is extremely important. It is the second condition after hard training to achieve success. In practical terms it constitutes 50-60% of the success," Olti added. It is therefore he especially thanks his parents who have supported him in making his dream come true, namely winning the Olympic gold medal in swimming.

When we asked him to mention some of his most important results in addition to his achievements at the Sarajevo meeting, Olti also recalled his success last year at the All National Championship in Durrës, Albania. Because this is the first time he set a new record time for the 2003-2004 generations in the 50 meter free style competition. Another major achievement is the fact that Olti has managed all this without drop his school results. He continues to be an excellent student, although as he put it he finds it very difficult in addition to swimming to find time to learn and to be with his friends. However, although swimming takes priority so far he has managed to excel in all fronts. According to him, this is possible only if you find something that you truly love as he loves swimming, after that nothing is too difficult. In that case hard work and dedication will not be in vain and there is no limit to what we can achieve. Olti himself wants to fulfill his potential to the maximum and become a swimmer like Michael Phelps.

SI TË BËNI SELFIE TË MIRË: KËSHILLA QË IA VLEJNË

Gjithkush bën selfie të paktën herë pas here, edhe pse disa e bëjnë më në fshehtësi e disa jo. Ne të gjithë brengosemi me atë se si të dukemi më mirë në foto. Dhe sa herë që bëjmë selfie, pyesim veten se cilat poza në selfie janë më të hijeshme dhe më pak pretencioze. Ne gjithashtu e dimë se ka situata kur nuk është ide e mirë që të bëhet dhe të postohet selfie. Por përndryshe, më së shumti mundohemi që ta kuptojmë se si të bëhet një selfie e mirë. Për fat, nuk është aq e vështirë sa mendoni. Njerëzit e thjeshtë si ne mund të mos duken 'cool' aq me lehtësi si modelet dhe yjet e filmit kur dalin në foto. Ndoshta nuk mund t'i nxjerrim pozat e njëjta selfie që duken aq të mrekullueshme madje edhe me ndriçim të patëmetë (por edhe dukjen e tillë). Por lehtë mund të mësoni se si të bëni selfie të mirë dhe të argëtoheni gjatë mësimit. Lexoni më poshtë disa këshilla më të mira për selfie. Ju premtojmë se do ta shihni dallimin, pavarësisht se a e bëni foton për t'ia dërguar mikut më të afërt apo për ta postuar për t'u parë nga të gjithë përcjellësit tuaj në Instagram.

Zgjidhe pozën perfekte për selfie

Pozat e selfies janë pjesë shumë e rëndësishme e bërjes së fotografisë së duhur. Nuk mundeni thjesht ta drejtoni kamerën e telefonit të mençur drejt fytyrës dhe ta bëni një fotografi të shkëlqyer pa u menduar fare. Mund t'ua japim një listë të pozave për selfie për t'i provuar, por strategjia më premtuese është që të eksperimentoni me kënde dhe pika të favorshme për të gjetur paraqitjet më të kënaqshme për ju. Provoni ta ktheni anën e djathtë të fytyrës në drejtim të kamerës dhe pastaj provoni anën e majtë. Shikoni se çka ndodhë nëse e mbani telefonin pak më lartë ose më ulët sesa zakonisht. Pasi ta kuptoni anën e mirë ose këndin e preferuar, mendoni çka të bëni me krahët, duart dhe qëndrimin. Nuk është gabim nëse frymëzoheni nga supermodelet. Ato shpesh e dinë saktësisht se çka duket mirë dhe e bëjnë të njëjtën gjë sa herë që bëjnë selfie.

Choose the perfect selfie poses

Selfie poses are a pretty important part of taking the right photo. You can't just point your smartphone camera at your face and capture a great photo without thinking things through. We could give you a list of selfie poses to try, but the most promising strategy is to experiment with angles and vantage points to find the poses that are the most flattering for you. Try turning the right side of your face toward your camera, and then try the left. Check out what happens if you hold your phone slightly higher or lower than usual. Once you know which your good side is or which angles you prefer, you can figure out what to do with your arms, hands, and posture. You can't go wrong by taking some inspiration from supermodels. They often know exactly what looks good and do the same thing each time they take a selfie.

Fytyra të mos jetë tepër afër kamerës

Nuk mund ta bëni selfien e hijshme nëse e afroni fytyrën shumë afër kamerës – përveç nëse dëshironi që hunda të duket e madhe apo vetullat të duken çuditshëm. Por, pak prej nesh e dinë pse. Pjesa e fytyrës suaj që është më afër kamerës duket më e madhe sesa tiparet e pjesës tjetër të fytyrës. Kjo shpjegon pse hunda mund të duket shumë e madhe, e jo veshët.

Make sure your face isn't too close to the camera

You can't take a flattering selfie with your face too close to the camera - at least not if you don't want your nose to look to big or eyebrows to look weird. But few of us know why. The part of your face that is closer to the camera look larger than the features on the rest of your face. That explains why it's your nose, not your ears that might look too big.

Kërko dritë të ndritshme

Kur në fillim mundoheni ta bëni një selfie të mirë, ndriçimi nuk duket si gjëja më e rëndësishme. Por besoni: ndriçimi i mirë është po aq i rëndësishëm sa edhe vetë poza e mirë. Të gjithë fotografët, pa marrë parasysh lëndën e tyre, e dinë se drita natyrore është pothuajse gjithmonë më e mira. Duhet ta kërkoni llojin e dritës së ndritshme duke qëndruar pranë dritares. Një tjetër këshillë e dobishme, shikoni drejt burimit të dritës për t'i shmangur hijet e çuditshme ose të pahijshme. Kur ta kërkoni ndriçimin e duhur për selfie gjithashtu duhet t'i kushtoni vëmendje sfondit. Sfondi i duhur e shton interesin por të mos jetë tepër i ngarkuar. Zakonisht sfondi më i mirë është super i thjeshtë ose shumë interesant. Kur ta zbuloni vendin e duhur për selfie, zgjidheni vendin me dritë të ndritshme dhe të bukur. Dhe kërkoni një sfond që ofron interesim vizual dhe gjithashtu komunikon se pse e zgjodhët për selfie.

(Burimi: https://www.cheatsheet.com)

HOW TO TAKE A GOOD SELFIE: WORTHY TIPS TO KNOW

Everybody takes a selfie at least occasionally, though some are more surreptitious than others. We all worry about how to look better in photos. And each time we take a selfie, we wonder which selfie poses are the most flattering and the least pretentious. We also know there are situations when it's never a good idea to take and post a selfie. But otherwise, we're mostly concerned with figuring out how to take a good selfie. Fortunately, it's not as difficult as you think. Mere mortals like us might never look as effortlessly cool as models and movie stars when they take a photo. We probably can't pull off the same selfie poses that look great when you have impeccable lighting (and the looks to match). But you can pretty easily learn how to take a good selfie and have fun in the process. Read on to check out best selfie-taking tips. We promise they'll make a difference, whether you're snapping a photo to send to your closest friend or to post for all your Instagram followers to see.

Sigurohuni që fotot të duken mrekullueshëm - vetëm mos e teproni me filtra

Nëse kërkoni në dyqanin e aplikacioneve të iOS ose në dyqanin e Google Play, ekziston një koleksion praktikisht i pafund i aplikacioneve që mund t'i bëjnë fotografitë tuaja të Instagramit të duken mirë. Mund të shkarkoni aplikacione që ofrojnë filtra me ngjyra të shkëlqyera, ose zgjidhni njërën që ju ndihmon të krijoni fotografi të shkëlqyeshme bardhë e zi. Përndryshe mund ta zgjedhësh një aplikacion gjithpërfshirës për editim, ose një që është projektuar për t'i bërë selfiet të duken të përsosura. Pavarësisht aplikacionit që e zgjedhni e kemi një kështillë të rëndësishme: mos shtoni shumë filtra. Edhe nëse i krahasoni filtrat e ngërthyera në Instagram, keni mjaft opsione. Nuk ka asgjë të keqe kur i bëni disa editime në foton tuaj ose nëse e shtoni ndonjë filtër. Vetëm mos e përdorni secilin filtër që është në dispozicion. Fundja, fotografia duhet të duket sadopak natyrale.

Make your photos look great - just don't add too many filters

Whether you're looking in the iOS App Store or Google Play Store, there's a practically endless array of apps that can make your Instagram photos look great. You can download apps that offer great colour filters, or pick one that helps you create great black-and-white photos. Alternately, you can pick a versatile editing app, or choose one that's designed to make your selfies look perfect. Whatever app you choose, we have an important piece of advice: Don't add too many filters. Even if you're just comparing the filters built in to Instagram, you have plenty of options. There's nothing wrong with making some light edits to your photo or adding a filter. Just don't pile on every filter that's available. You still want the photo to look at least a little bit natural.

Look for bright lighting

When you're first figuring out how to take a good selfie, lighting doesn't seem like the most important thing. But trust us: Great lighting is just as important as good selfie poses. All photographers, no matter their subject matter, know natural light is almost always best. You should look for the kind of bright light you'll get by standing right next to a window. Another useful tip? Look straight toward the light source to avoid weird or unflattering shadows. When you look for the right lighting to take a selfie, you also should pay attention to the background. The right background will add interest without being too busy. Usually, the best background will either be super simple or very interesting. When you scout out the right selfie-taking spot, choose a location with bright, flattering light. And look for a background that offers visual interest and also communicates why you chose to take a selfie.

Bëni selfie vazhdimisht

Edhe nëse i mësoni të gjitha që duhet t'i dini rreth asaj se si bëhet një selfie e mirë, jo çdo herë do të bëni foto perfekte. S'ka problem. Zgjidhja është shumë e lehtë: bëni më shumë selfie. Njerëzit që fotografojnë rregullisht janë më të kënaqur se si duken në foto. Ata gjithashtu gradualisht mësojnë t'i bëjnë fotografitë ashtu si dëshirojnë. Ndërsa mësoheni me fotot që ia bëni vetes, ju me gjasë do të dukeni më natyral me kalimin e kohës. Do të ndjeheni më rehat me atë se si dukeni në këto foto dhe ndoshta do të argëtoheni më shumë kur bëni foto. Nëse ky nuk është qëllimi i bërjes së selfieve, atëherë nuk e dimë se çka është. Argëtohuni dhe jini vetja.

Keep taking selfies

Even if you learn everything there is to know about how to take a good selfie, you might not get a perfect photo every time. That's OK. There's a pretty easy solution: Just take more selfies. People who routinely photograph themselves end up being more comfortable with the way they look in photos. They also gradually learn to make their photos turn out the way they want. As you get more used to seeing photos you've taken of yourself, you'll likely find that they look more natural over time. You'll get more comfortable with the way you look in those photos, and you'll probably find it's easier to have fun when you're taking a photo. If that's not the point of taking a selfie, then we don't know what is. Have fun, and be yourself.

(Source: https://www.cheatsheet.com)

#WIKIGAP – TA MBYLLIM HENDEKUN GJINOR NË INTERNET

Këtë vit, në Ditën Ndërkombëtare të Gruas, nisma #WIKIGAP, që kishte për qëllim të rriste përfaqësimin e grave në Wikipedia, u nis nga Ambasadat Suedeze në mbarë botën. Në Prishtinë, rreth 30 vullnetarë të rinj morën pjesë në ngjarje, që të mundohen të mbyllin hendekun gjinor në Internet, duke shtuar artikuj të rinj dhe redaktues për gratë nga gratë e Kosovës.

Si enciklopedia më e madhe botërore në internet dhe e krijuar nga përdoruesit, Wikipedia ka potencialin për të ndikuar në pikëpamjet tona të botës dhe të njerëzve në të. Brenda kësaj platforme të fuqishme, ekziston një çekuilibër i madh midis burrave dhe grave, ashtu si në shoqërinë e gjerë. Konkretisht kjo do të thotë: 90% e atyre që shtojnë përmbajtje në Wikipedia janë burra dhe artikujt janë të shkruar nga burrat katër herë më shumë sesa nga gratë. Shtrirja e këtij diskriminimi nuk është e njëjtë kudo dhe ka dallime rajonale. Megjithatë, është e qartë se informacioni rreth grave është më pak i gjerë. Jo vetëm që gratë nuk janë të përfaqësuara në Wikipedia, por një studim i vitit 2016 (Wagner et al., 2016: Women through the glass ceiling: gender asymmetries in Wikipedia. Gjendet në: https://epjdatascience.springeropen.com/articles/10.1140/epjds/s13688-016-0066-4) tregoi se biografitë për gratë shpesh përmbajnë terma negativë krahasuar me biografitë e burrave..

Për të ndryshuar këtë pabarazi dhe për të mbyllur këtë boshllëk të informacionit, Ministria e Punëve të Jashtme të Suedisë dhe Wikimeida, fondacioni prapa Wikipedia, në Ditën Ndërkombëtare të Gruas, më 8 mars 2018, nisën nismën globale #WikiGap. Mendimi shkon që një Wikipedia më e barabartë gjinore dhe Interneti ndihmojnë në krijimin e një bote të barabartë gjinore. Nisma #WikiGap është pjesë e politikës së jashtme feministe të Suedisë dhe synon të forcojë të drejtat, përfaqësimin dhe burimet e grave dhe vajzave.

Ambasada Suedeze në Prishtinë dhe partnerët që kanë përvojë të gjatë në punën me barazi gjinore në Kosovë, si Zyra e "UN Women" në Prishtinë, organizuan ngjarjen #WikiGap. GlobalGirl Media në KosovaLive ishte partneri kryesor i ngjarjes dhe ofroi hapësirën dhe përgatitjet praktike për ngjarjen. Universiteti i Prishtinës dhe Biblioteka Kombëtare e Kosovës ofruan burime për artikujt dhe Hallakate, Prishtina Hackerspace, Iniciativa Kosovare për Stabilitet dhe Softuari i Lirë i Burimeve të Hapura në Kosovë, kontribuuan me ekspertizë teknike.

Mbi 50 vende të botës mbajtën në të njëjtën kohë ngjarjet e ngjashme. Të gjitha këto ngjarje u lehtësuan nga stafi i Ambasadës së Suedisë, por të gjitha shkrimet dhe redaktimet u bënë nga vullnetarët, të cilët kishin marrë pjesë më parë në një punëtori udhëzuese dhe, ashtu si garuesit e tjerë, iu nënshtruan të njëjtit kontroll të cilësisë nga Wikipedia. Rreth 30 vullnetarë të rinj në Prishtinë, të gjithë të përkushtuar dhe entuziastë, u mblodhën së bashku për të bërë më të barabartë Internetin, duke përditësuar Wikipedia me një pikëpamje kosovare, që përqendrohej në gratë e rëndësishme të vendit. Vullnetarët po punonin së bashku në grupe të vogla për të kontribuar në këtë tablo më të saktë të shoqërisë në Internet dhe shtuan më shumë se dhjetë artikuj të ri në Wikipedia dhe, gjatë ngjarjes, redaktuan ato tri ekzistueset.

Ambasadori i Suedisë në Prishtinë, Henrik Nilsson, e mbylli ngjarjen #WikiGap dhe ju bëri thirrje pjesëmarrësve që vazhdimisht të angazhohen dhe të jenë aktivë dhe ju tha: "Kur të largoheni nga ky vend dhe t'i ktheheni botës si qytetarë, shpresoj se do ta merrni me vete edhe entuziazmin që e keni treguar këto ditë këtu. Ju jeni ai brez që do të formësoni të ardhmen e Kosovës".

Në përgjithësi dhe deri më tani, më shumë se 1600 pjesëmarrës nga më shumë se 50 shtete kanë shtuar dhe kanë përditësuar rreth 3000 artikuj në Wikipedia për gratë e shquara në mbi 30 gjuhë të ndryshme.

Për më shumë informata mbi #WikiGap dhe këshillë se si të bëheni redaktor i Wikipedia për të mbyllur hendekun gjinor në internet, ju lutem vizitoni:
http://www.swemfa.se/wikigap/

#WIKIGAP – LET'S CLOSE THE INTERNET GENDER GAP

On International Women's Day this year, the #WikiGap initiative to increase women's representation on Wikipedia was launched by Swedish Embassies around the world. In Pristina, around 30 young volunteers participated in the event to close the gender gap on the Internet by adding new and editing existing articles about women by women from Kosovo.

As the world's largest online and user-generated encyclopedia, Wikipedia has the potential to influence our views of the world and the people within. In this powerful platform there is great imbalance between men and women, just like in society at large. Subsequently this means that 90% of those who add content to Wikipedia are men and four times more articles are written about men than women. The extent of this imbalance is not the same everywhere and there are regional differences. However, it is clear that information about women is less extensive. Not only are women underrepresented on Wikipedia, a study from 2016 (Wagner et al., 2016: Women through the glass ceiling: gender asymmetries in Wikipedia. Available under: https://epjdatascience.springeropen.com/articles/10.1140/epjds/s13688-016-0066-4) showed that biographies about women frequently contain more negative terms compared to biographies about men.

To change this inequality and to close this information gap, the Swedish Ministry of Foreign Affairs and Wikimedia, the foundation behind Wikipedia, launched the global #WikiGap initiative on International Women's Day on March 8th 2018. The thinking goes that a more gender-equal influence on Wikipedia and the Internet helps create a more gender-equal world. The #WikiGap initiative is part of Sweden's feminist foreign policy with the ambition to strengthen women's and girl's rights, representation and resources.

The Swedish Embassy in Pristina organized a #WikiGap event with partners who have experience working with gender equality in Kosovo, such as the UN Women's Office in Pristina. GlobalGirl Media at KosovaLive was the event's main partner and provided the location and practical preparations for the event. Source articles were provided by the University of Pristina and Kosovo National Library Hallakate, Pristina Hackerspace, Kosovar Stability Initiative and Free Libre Open Source Software Kosova contributed with technical expertise.

Similar edit-a-thons were held in parallel in over 50 countries around the world. These events were all facilitated by Swedish Embassy staff, but all writing or editing was done by volunteers, which have attended an instruction workshop beforehand, and underwent the same quality control required by Wikipedia. In Pristina, around 30 young volunteers, all very committed and enthusiastic, came together to make the Internet more equal by updating Wikipedia with a Kosovar perspective focusing on the country's notable women. The volunteers worked together in small groups to contribute a more accurate picture of society on the Internet and added more than ten new articles to Wikipedia and edited three existing ones during the event.

The Ambassador of Sweden in Pristina, Henrik Nilsson, closed the #WikiGap edit-a-thon and urged the participants to continuously be engaged and active by saying "As you leave this room and go back out in the world as citizens, I hope you can bring your enthusiasm as you have shown here today. It is your generation that will shape the future of Kosovo".

Overall and up until now, more than 1600 participants from more than 50 countries have added new or updated some 3000 articles on Wikipedia on prominent women in over 30 different languages.

For valuable information on #WikiGap and advice on how to become a Wikipedia editor to close the Internet gender gap visit: **http://www.swemfa.se/wikigap/**

Na vizitoni në:
Visit us at:

SYNIMI I 8: PUNËSIM I MIRË DHE RRITJE EKONOMIKE

8 PUNËSIM I MIRË DHE RRITJE EKONOMIKE

NGA: MARGREET DE HEER


GOAL 8: DECENT WORK AND ECONOMIC GROWTH
8 DECENT WORK AND ECONOMIC GROWTH
BY: MARGREET DE HEER
"DECENT WORK"...?
WHAT DOES THAT MEAN?
IT MEANS WE HAVE TO MAKE SURE...
1. EVERYONE CAN FREELY CHOOSE A SAFE, FAIRLY PAID, SECURE AND FULFILLING JOB
2. BUSINESSES USE NATURAL RESOURCES WISELY
3. NO ONE IS EXCLUDED FROM WORK OPPORTUNITIES
MEN AND WOMEN
PEOPLE WITH DISABILITIES
YOUNG PEOPLE
MIGRANT WORKERS
4. UNEMPLOYMENT IS REDUCED BY PROVIDING TRAINING
TRAINING
JOB
5. TO END AND PREVENT CHILD LABOR, FORCED LABOR AND MODERN SLAVERY
SCHOOL
6. EVERYONE CAN BENEFIT FROM A GROWING ECONOMY
FUTURE
JOB
COMICS UNITING NATIONS

Këndi juaj

LIBRI

Pasi e lexova letrën, u pendova për gjithçka që i thashë atij. Duhet ta kisha lënë që të shpjegohej mbi atë se çka ndodhi, por isha e zemëruar, nuk isha vetvetja. E pashë orën dhe kisha kohë të mjaftueshme për t'u përgatitur dhe për të shkuar në park. Kisha veshur një bluzë verore, pantallona rozë dhe atletet e mia. Arrita në kohë, Marko ishte aty dhe kisha të njëjtën ndjenjë si në kohën kur i pata folur për herë të parë. U ula pranë tij dhe për një çast nuk folëm me njëri-tjetrin, ishte një çast heshtjeje. Ai filloi bisedën; me tregoi çdo gjë që nga fillimi. E kuptova se i kisha munguar po aq sa më kishte munguar ai mua. Pastaj, ai më tha se më dashuronte dhe se unë isha vajza e vetme në jetën e tij; isha e ndrojtur, por të jem e sinqertë nuk kisha ndonjë arsye të ndihesha ashtu sepse edhe unë e dashuroja atë, kështu që ishim të barabartë në këtë drejtim. Më kapi për dore dhe më tha se asgjë dhe askush kurrë nuk mund të na ndajë, gjersa e gjithë kjo ndodhi kur po e vështronim pamjen e bukur të perëndimit të diellit në parkun e qytetit. Ishim qetësia e njëri-tjetrit në stuhi...

FUND

"Shpresoj t'ju ketë pëlqyer libri, është ditari i Anës, të cilin e kam publikuar para 10 vjetëve, gjegjësisht një vit pas ajo ndërroi jetë dhe nuk jam i sigurt se çka do të bëjë me jetën time. Ajo më dashuronte aq shumë dhe e ka ditur mirë se nuk isha i përkryer, mirëpo gjithsesi ajo më dashuroi. Ajo ishte gjëja më e bukur që më kishte ndodhur ndonjëherë, ishim aq të ngjashëm, kishim një dashuri të rrallë dhe të pastër, por shpresoj se ajo është në parajsë tani sepse me të vërtetë e meriton! Jeta vazhdoi, mirëpo nuk ishte më kurrë njëjtë sepse askush nuk do të jetë i pranishëm përgjithmonë në jetën tonë."

Marko (lypësi)

Isha e tronditur, vërtet e tronditur; ky ishte një nga librat më të trishtuara që kam lexuar ndonjëherë; ky libër më dha një ndjenjë të lumturisë dhe të trishtuara, d.m.th. ndjenja të përziera. Isha e lumtur që më në fund ishin së bashku, por e trishtuar që Ana kishte vdekur dhe se Marko tani është një lypës që jeton në rrugë. Mësova se dashuria e vërtetë ekziston dhe ne vetëm duhet të jemi të guximshëm ta gjejmë atë ose ta lemë dashurinë të na gjejë … sepse një dashuri e tillë nuk vdes kurrë.

Your corner

THE BOOK

After I read the letter, I regretted everything I said to him. I should've left him to explain what happened but I was angry, I wasn't myself. I saw the clock and I had more than enough time to get ready and go to the park. I wore a summer blouse, pink pants and my sneakers. I arrived in time, Marko was there and I had the same feeling as at the time when I first spoke to him. I sat beside him and for a moment we didn't talk to each other, it was a moment of silence. He started the conversation; he told me everything from the very start. I realized that he missed me as much as I missed him. Then, he said that he loved me and that I was the only girl in his life, I was shy but to be honest I had no reason because I loved him too, so we were equal now. He grabbed my hand and said that nothing and nobody can separate us, never, while we were looking at the beautiful view of the sunset in the city park. We were each-other's calm in the storm…

THE END

"Hope you liked the book, it's Ana's diary, I published it 10 years ago, a year after her death and I'm not sure what I'm going to do with my life. She loved me too much knowing good that I wasn't perfect but she loved me anyway. She was the most beautiful thing that ever happened to me, we were so similar, we had a rare and a pure love, but I hope that she's in heaven now because she really deserves it! Life went on, bit it was never the same again because no-one is meant to stay forever."

Marko (the beggar)

I was shocked, really shocked, this was one of the saddest books that I ever read; it gave me a happy and a sad feeling, a mixed feeling. I was happy that they finally were together, but sad that Ana is dead and that Marko now is a beggar who lives in the street. I learned that true love exists and we just have to be brave to find it or to let the love itself to find us…because this kind of love never dies.

AKTORJA E NJOHUR NGA FOTO
NATRIUM
DHOMA
DUKURI E RE (SH.)
HERO I TROJËS (SHQ.)
LLOJ SHEQERKE (PASHQ.)
LLOJ BLUZE ESKIMEZE
LUMË NË MAQEDONI
50 (ROMAK)
BANOR I ASIRISË SË LASHTË
TË MBIJETUARIT
PËREMËR PRONOR
SHKRIMT. ERENBURG
QË I TAKON ANATOMISË
PËRMBUSHJE E NJË URDHËRI
ZANORJA E DYTË
AKTORJA EKBERG
SEZON
AFROHU
AKTORI PAÇINO
NGACMIM (SHQ.)
PJESË E SYRIT (PASHQ.)
ELEKTRONI
I VOGLI I BUALLICËS
MBETEM PA GOJË
NJË LËNDË SHKOLLORE
YLL ME BISHT (SH.)
URAN, METËR
SMIRË, RESË
KËTU (FR.)
AMËNORE
ZANORE TË NJËJTA
KFOR
KΦOP
MJET PËR TË SITUR
SHËNDETËSI (SHQ.)
PADITJA
EMËRTIM I LASHTË PËR VIETNAMIN
ISH-TRAJNER ITALIAN I FUTBOLLIT, ARIGO
SPECIALISTI NË ENERGJ. ATOMIKE
FLUTURUËS I PARË (MIT.)
ZANORJA E PARË
SOLIST AMERIKAN
AKTET KRIMINELE
SËMUNDJE E RËNDË
SUNDIMTARI I EGËR
PJESË E RADIOS APO TELEVIZORIT
NAIM KRASNIQI
THIRRJA E MYEZINIT
PËRKULJA NGA NJËRA ANË
RADIUM
NDJENJA E LAKMISË
LËKURË E PAPËRPUNUAR
PUNUES VIOLINASH NGA KREMONA (ITALI)
EMËR (M.)
FILOZOF (FR.) SIMON
EMËR FEMRE
VOZË E MADHE DRURI PËR DJATH, GJIZË ETJ
LUMË NË KINË
"TRANSPORTIMPORT"
TEMPERATURA
PA DOBI
PRINC ARAB
E JASHTËZAKONSHME, VIGANE
TELUR
QË I PËRKET NJË TEMË TË CAKTUAR
MBRET ROMAK QË DOGJI ROMËN
RADIUS
UDHËPËRSHKRIM (SHQ.)
PËREMËR VETOR

Letrat e lexuesve

Tung tung!
Jam Edonita Thaçi nga Gjilani. Jam 13 vjeçare. Vijoj mësimet në shkollën fillore "Hasan Prishtina" në Gjilan. Revista juaj më pëlqen shumë, vetëm vazhdoni. Këngëtari im i preferuar është Blero andaj do t'ju kisha kërkuar që të shkruani më shumë për jetën e këtij këngëtari dhe ta publikoni posterin e tij. Sporti im i preferuar është noti, aktori im i preferuar është Brad Pit. Suksese!
Edonita Thaçi
SHFMU "Hasan Prishtina"- Gjilan

Përshëndetje!
Jam Drita nga Gjakova. Së pari dua t'ju falënderohem shumë për këtë revistë të shumë pëlqyer nga ne dhe dua t'ju shpreh dëshirën që në njërin nga numrat e ardhshëm, në këndin e shkollës së muajit të zërë vend shkolla jonë. Me këtë ju do të plotësonit dëshirën e të gjithë shoqeve dhe shokëve të mi të shkollës. Suksese.
Drita Hoxha
SHFMU "Edmond Hoxha"- Gjakovë

Tung!
Revista juaj është OK! Këngëtarja ime e preferuar është Genta Ismajli andaj ju kisha lutur që të shkruani diçka për jetën e saj e po ashtu edhe të publikoni posterin e saj. Me shpresë se kërkesa ime do të has në mirëkuptimin e redaksisë suaj, unë ju falënderoj që tani dhe ju uroj suksese.
Vlera Hoxha
SHFMU "Edmond Hoxha"- Gjakovë

Përshëndetje të përzemërta!
Këngëtari im i preferuar është Alban Skenderaj, CD-ja ime e preferuar është "Eklips". Sporti im i preferuar është volejbolli, aktorja ime e preferuar është Julia Roberts dhe kisha pasur dëshirë që të kem një poster të Alban Skenderaj. Revista juaj më pëlqen shumë - ju vërtetë jeni më të mirët! Më pëlqejnë të gjitha rubrikat, por kisha pasur dëshirë që të shkruani për filma dhe seri televizive. Ju dëshiroj sukses me punën e mëtutjeshme!
Leart Hyseni
SHFMU "Edmond Hoxha"- Gjakovë

Përshëndetje!
Më pëlqen grupi muzikor "One Direction", janë shumë të mirë dhe kisha dashur që të bëni një intervistë me ta. Aktorja ime e preferuar është Yllka Gashi dhe do të kisha pasur dëshirë që të botoni një poster të saj. Kur kam kohë të lirë, më pëlqen të lexoj kurse sportet e mia të preferuara janë volejbolli dhe basketbolli.
Jeni të përkryer, ju them me sinqeritet se jeni më të mirët. Prindërit e mi po ashtu ju adhurojnë sepse edhe ata gjithmonë e lexojnë revistën For You. Do të kishit mundur ta rrisnit numrin e faqeve dhe të shkruani më shumë për sport dhe për disa gjëra interesante lidhur me jetën e njerëzve në Kosovë dhe në botë.
Noa Morina
SHFMU "Edmond Hoxha"- Gjakovë

Nr.147

Pyetjet:

1. Këngëtari/ja dhe grupi më i preferuar: _____
2. CD-ja e preferuar: _____
3. Cili është filmi i juaj i preferuar: _____
4. Aktori/ja e preferuar: _____
5. Kisha dëshiruar të kem poster nga: _____
6. Si e kaloni kohën e lirë: _____
7. Sporti më i preferuar: _____

Nëse dëshironi të shkruani diç më tepër (për hobin tuaj, sa ju pëlqen revista jonë apo diç tjetër) shumë thjeshtë, shkruaj më poshtë.

Readers' letters

Hi!
My name is Edonita Thaçi and I am from Gjilan. I am 13 years old and I am a student at the EJHS "Hasan Prishtina" in Gjilan. I like your magazine very much; just keep following the same path! My favorite singer is Blero and I would like to ask you to publish a poster of this popular singer and to write something more about his personal life. My favorite sport is swimming, whereas my favorite actor is Brad Pitt. I wish you lots of success in the future!
Edonita Thaçi
EJHS "Hasan Prishtina" - Gjilan

Hello!
My name is Drita and I come from Gjakova. First of all, I would like to thank you for this magnificent magazine and I would like to ask you to come and visit our school and write about it in your "School of the Month" column in one of your next editions. By doing so, you would also fulfill the wish of all my school friends. I wish you lots of success in the future!
Drita Hoxha
EJHS "Edmond Hoxha" - Gjakovë

Hi!
Your magazine is OK! My favorite singer is Genta Ismajli and I would like to ask you to write something about her personal life as well as to publish a poster of this popular singer. I hope that your editorial office will be able to fulfill my wish and I thank you in advance for your consideration! I wish you lots of success in the future!
Vlera Hoxha
EJHS "Edmond Hoxha" - Gjakovë

Hello everyone!
My favorite singer is Alban Skenderaj. My favorite CD is "Eklips" (Eclipse). My favorite sport is volleyball, my favorite actress is Julia Roberts and I would also like to have a poster of Alban Skenderaj. I like your magazine very much – there is no doubt that you are the best! I enjoy reading all your columns; however, I would like to ask you to write more about movies and TV series. I wish you lots of success in the future!
Leart Hyseni
EJHS "Edmond Hoxha" - Gjakovë

Hello!
My favorite music band is "One Direction", this is a great band and I would like to ask you to have an interview with the members of this band. My favorite actress is Yllka Gashi and I would also like to ask you to publish a poster of hers. When I have some free time, I prefer to read various books, whereas my favorite sports are volleyball and basketball. You are just perfect; I really mean it: you are the best! In addition, my parents also like your magazine and they always enjoy reading the new editions of For You magazine. You could perhaps increase the number of pages and write more about sports and other various topics, which are popular amongst people in Kosovo and all around the world!
Noa Morina
EJHS "Edmond Hoxha" - Gjakovë

Nr.147

Lexues tanë të dashur!

Na duhet ndihma juaj!

Përdoreni këtë pjesë që të na tregoni:

- Çka ju interesoni
- Çka ju pëlqen
- Çka dëshironi

Është rasti juaj që të merrni pjesë në krijimin e revistës tonë. Andaj ju lusim që të plotësoni këtë pjesë, nëse mundeni dhe t'ia dorëzoni një ushtari të KFOR-it

Me ndërime !

for You

Shkruaj adresën më poshtë:

Mbiemri: _____

Emri: _____

Data e lindjes: _____

E-mail: _____

Rruga: _____

Numri: _____

Qyteti: _____

Shkolla: _____

Adresa e shkollës: _____

Numri i tel. të shkollës: _____

E-mail i shkollës: _____

Fute këtë pjesë në një zarf, vendosi një pullë postale dhe dërgoje në adresën e mëposhtme:

HQ KFOR
Film City
For You magazine
Strasbourg building
10 000 Pristina

Ose vetëm dorëzojani cilitdo ushtar të KFOR-it me kërkesë që ta dërgojë më tutje.

for You
www.magazineforyou.com